

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7626 E hënë 20 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Disa nga tiparet e kësaj sjelljeje politike u panë qartë dhe të sh-tunën e kaluar në Berlin në takimin Merkel-Putin. Larg ankesave, akuzave, deklarimeve ...
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

Kryemodel i sjelljes politike



Opinion **i** Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

1. Garën e ke me ata që të kanë vënë në timon, jo me makinën rivale që nxjerr aq shumë tym nga skapamento, motorri i së cilës dëgjohej që nuk punon mirë ...
Vijon në faqen 21

Këshilla timonierit të makinës së lodhur



Paloka: Rama bashkëqeverisë me kriminelë, me ta pastron paratë

Arrestimi i Begos, PD: Miku i Aldo Bares u mbrojt nga Balla, bëjnë biznes bashkë

Kundërpërgjigjet Ndreu: Opozitë e lajthitur, e liri qeveria juaj

Opozita akuzoi dje mazhorancën qeverisëse për lidhje të forta me kriminelët. Nënkryetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka bëri dje të ditur se një trafikant ndërkombëtar droge jeton i lirë në Shqipëri dhe është i përfshirë në biznesin e ndërtimit. Paloka tha se mbrëmjen e së shtunës u arrestua nga policia greke, Edmond Bego ...
Në faqen 3

INSTITUTI I SIGURIMEVE: CILAT JANE KATEGORITE QE DO PERFITOJNE ME SHUME

VENDIMI, RITJE PENSIONESH PER USHTARAKET, SA DO MARRIN

ISSH sjell shembujt konkretë: Beni kujdes, ja formula e saktë e përllogaritjes. Qeveria vendosi indeksimin, në masën 2.8 për qind



(Në foto) Ushtarake

AUTORI ENDE ANONIM

Grabitet karburanti në Lezhë, plagoset me armë roja Martin Prenga: Çfarë më tha...
Në faqen 5

PERPLASJA ME POLICINE

Incidenti me "Tuareg", shpallet në kërkim i afërmi i Durim Bamit, në burg 2 të tjerë
Në faqen 6

KRYENGRITJA E ZHAPOKIKES

Dalin dokumentet kur klerikët 'predikonin' kundra komunizmit, ja personazhet kryesorë
Në faqen 18-19

ORIENTIM TE RINJVE

Ambasada: Si të fitoni të drejtën e studimit në Amerikë dhe kriteret që duhet të plotësohen
Në faqen 10

KESHILLAT E YLLI MERJA PER TRAJTIMIN E ARTRITIT



Entela Basha: Si të trajtoni sindromin e demencës. Kujdes, pasojat janë të rënda
Suplement

Flet mjeku i njohur: Reforma në sistemin shëndetësor, "ilaçi" i vetëm

Deliallisi: 175 mjekë të larguar nga Shqipëria në 2017

"Pagat e ulëta e konfliktualiteti me pacientët, faktorët kryesorë"

Nga VOLTIZA DURO

Vitet e fundit po vihet re tendenca e largimit të bluzave të bardha nga Shqipëria, të cilët zgjedhin të braktisin vendin dhe të ushtrojnë profesionin e tyre në një shtet tjetër. Sipas statistikave, në vitin 2017,



EKSKLUZIVE

numri i mjekëve të larguar ka arritur në 175, që kryesisht janë specialistë apo të rinj. Në një intervistë ekskluzive për 'Gazeta Shqiptare', mjeku endokrinolog, Shefqet Deliallisi tregon se aktualisht po largohet pjesa më cilësore ...
Në faqen 8

DREJTËSIA NGËRÇI

Gjonaj: Shpresojmë që në shtator të paktën të fillojmë të ngremë dy institucionet e reja

Ngërçi në drejtësi, vetingu "rrezon" kandidatët për KLGJ dhe KLP

Shkelen afatet kushtetuese me 16 muaj

Reforma në drejtësi nuk po gjen zbatimin e saj brenda afateve kushtetuese duke krijuar një ngërç për ngritjen e dy institucioneve më të reja, KLGJ dhe KLP. Në shkellje të afatit Kushtetues me 16 muaj dhe kandidatura të shpallura prej 20 muajsh, dy organet e reja të drejtësisë Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe ai i Prokurorisë, mbeten ende peng i procesit të vetingut. Vetëm 4 vendime larg përfundimit të listës së parë prioritare për këtë proces, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, deri më tani ka "skarcuar" 10 nga 33 kandidatët magistratë për KLGJ-në dhe KLP-në.



Ministrja e Drejtësisë
Etilda Gjonaj

it të Pavarur të Kualifikimit, i cili do duhet të rivlerësojë edhe kandidatët e rinj. Eshhtë ky rezultat ai që shkon kundër asaj që sot duket një deklaratë e nxjatur dhe shumë optimiste e ministres së Drejtësisë Etilda Gjonaj, e cila prej muajit

qershor njoftonte ngritjen e KLGJ dhe KLP në muajin shtator: "Nëse ecet me këto ritme, shpresojmë që në shtator të paktën të fillojmë të ngremë institucionet e reja KLGJ dhe KLP", është shprehur ministrja e drejtësisë Etilda Gjonaj.

VENDIMET

Vetëm 4 vendime larg përfundimit të listës së parë prioritare për këtë proces, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, deri më tani ka "skarcuar" 10 nga 33 kandidatët magistratë për KLGJ-në dhe KLP-në.

Vonesat në ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe atij të prokurorisë, shtyjnë në kohë jo vetëm zgjidhjen e ngërçit tashmë të thelluar me gjykatën Kushtetuese dhe atë të Lartë, por edhe zvarritjen e ngritjes së Byrosë Kombëtare të hetimit dhe Njësisë Speciale Antikorrupsion. E deri në ngritjen e këtyre dy institucioneve të pavarura, të vetmet që mund të hetojnë funksionarët e lartë, politika mund të flejë e qetë.



PROCESI

Rinisja e procesit për marrjen e kandidaturave të reja për zëvendësimin e atyre që vetingu ka eliminuar deri më tani, do të rikthejë topin në fushën e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili do duhet të rivlerësojë edhe kandidatët e rinj.

PËRBËRJA

Këshilli i Lartë i Gjyqësorit do të përbëhet nga: tre gjyqtarë të shkallës së parë, të paktën një prej të cilëve vjen nga gjykata jashtë Tiranës; dy gjyqtarë apeli, të paktën një prej të cilëve vjen nga gjykata jashtë Tiranës; një gjyqtar nga Gjykata e Lartë.

"Filloi vjeshta e fundit e Noriegës në Shqipëri!"

Berisha: Hetonte djalin e deputetit të PS për përdhunim, i hiqet dosja oficerit të policisë

Ish-Kryeministri Berisha shprehu dje nderimin e tij për tifozët e Tiranës, të cilët ditën e djeshme vendosën në ambientet e stadiumit "Selman Stërmasi", një bande rolë gjigande me thirrjen "Mburo Teatrin". Berisha shkruan se kjo ngjarje ishte inaugurimi i vjeshtës së tmerrshme dhe të fundit që e pret Edi Ramën. "Filloi tmerrri i vjeshtës së fundit të piktorit dëshakt! Të dashur miq, në stadiumin e Tiranës mijëra tifozë të ekipit të kryeqytetit inauguruan fillimin e vjeshtës së tmerrshme dhe të fundit të Edi Ramës. Ata, në një akt proteste dhe revolte shpalsën një bande-

rolë gjigande, në të cilën shkruhej me germa të mëdha: "Të mbrojmë Teatrin", trashëgiminë kulturore, që me historikun, arkitekturën e tij bën krenar çdo shqiptar, bën krenar çdo qytetar. Nderim të madh tifozëve të Tiranës, që nisën të parët revoltën që do realizojë fundin e tmerrshëm apo vjeshtën e fundit të Noriegës në Shqipëri!", shkruan ish-kryeministri Berisha. Ish-kryeministri Berisha, i cili denoncoi i pari skandalin e përdhunimit të një vajze nga djali i deputetit socialist në Krujë denoncoi së rish një skandal tjetër. "Ndëshkohet nga

feruar në Berat pas denoncimit të bërë publik. "Hakmarrja primitive e Edvin Kristaq Ramës! Ndëshkohet nga Xhafaj i drogës, Emiljano Nuhu, oficeri që hetoi skandalin e djalit të deputetit. Sb. "Fatmir Xhafaj ia ka hequr dosjen oficerit të Policisë Gjyqësore që po hetonte ngjarjen e rëndë të përdhunimit të një vajze nga djali i deputetit të PS në Krujë, Rrahman Rraja. Oficeri i Policisë Gjyqësore Emiljano Nuhu është transferuar në Berat pak pas denoncimit tuaj, pasi po mblidhte prova për fajësinë e djalit përdhunues të deputetit rilindas të Krujës Rrahman Rraja", thuhet në mesazhin drejtuar Berishës.



Xhafaj i drogës, Emiljano Nuhu, oficeri që hetoi skandalin e djalit të deputetit",

shkruan Berisha duke publikuar një mesazh ku shpjegohet se oficeri është trans-



Arrestimi i Edmond Begos, PD: Miku i Aldo Bares u mbrojt nga Balla, bëjnë biznes bashkë

Paloka: Rama bashkëqeverisë me kriminelë, me ta pastron paratë

"Bego njihet me 3 emra, bën biznes i qetë në Shqipëri"

Valentina Madani

Opozita akuzoi dje mazhorancën qeverisë për lidhje të forta me kriminelët. Nënkrjetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka bëri dje të ditur se një trafikant ndërkombëtar droge jeton i lirë në Shqipëri dhe është i përfshirë në biznesin e ndërtimit. Paloka tha se mbremjen e së shtunës u arrestua nga policia greke, Edmond Bego i dënuar me 21 vite burg në Itali për trafik ndërkombëtar droge, "biznesmen i lidhur ngushtë me pushtetin e Edi Ramës". Sipas PD-së, miku i Aldo Bares shëtiste lirisht në Shqipëri pavarësisht se mbi të rëndonte një dënim prej 21 vitesh burg për trafik droge. Paloka akuzoi deputetin socialist Taulant Balla si të lidhur direkt me Begon, pasi sipas tij, janë të lidhur në biznes. Paloka ngriti disa pyetje, e tekta nxori emrin e deputetit të PS Taulant Balla, tha se ditët në vijim PD do të bëjë transparencë përse ligji nuk ka vepruar ndaj Begos që njihet me emër tjetër për policinë, Italianë e biznesin në Shqipëri. Partia Demokratike e konsideron biznesmenin Edmond Bego, të arrestuar nga policia greke për llogari të italianëve, si njeri të lidhur ngushtë me pushtetin e Edi Ramës. Ndonëse Bego ishte dënuar në Itali me 21 vite burg për trafik ndërkombëtar droge, sipas demokratëve ai gëzonte mbrojtjen e qeverisë shqiptare, arsye për të cilën - theksojnë demokratët, - i kërkuari ka vijuar të qëndrojë i lirë. "Trafikanti ndërkombëtar i drogës, anëtarin i bandës së Aldo Bares jetonte i lirë në Shqipëri, ku drejtohej edhe një biznes ndërtimi, nën mbrojtjen politike të kësaj qeverie. Nëse Edmond Bego nuk do të ishte nisur me pushime në Greqi, sot shqiptarët nuk do të dinin se një kriminelin i rrezikshëm ka vazhduar të pasurohet lirisht, duke u lidhur drejtpërdrejt me disa nga njerëzit më të pushtetshëm në vend, edhe pse ishte i dënuar për trafik ndërkombëtar droge në Itali", tha nënkryetari i PD-së, Edi Paloka. Përmes nënkryetarit Paloka, demokratët për momentin i kanë akuzat në formë pyetjesh, ndonëse disa emra i lënë pa i përmendur. "Si është e mundur që një trafikant ndërkombëtar droge, i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet ital-



Nënkrjetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka

AKUZA

Policia e Iugumencës, në bashkëpunim me sektorin e kontrollit të pasaportave të Sajadhes, kanë arrestuar mbremjen e të shtunës të shumëkërkuarin shqiptar Edmond Bego, 48-vjeç. PD e konsideron biznesmenin Edmond Bego, të arrestuar nga policia greke për llogari të italianëve, si njeri të lidhur ngushtë me pushtetin e Edi Ramës.

TAULANT BALLA

"Partia Babalokratike filloi teatrin komik "Babale 3". Madje dy zëvendësata e Luzim Bashës bënë dhe prezantimin e skenarit. Meqenëse më drejtuan mua pyetje dy zëvendësata e Luzimit, unë kam dëshirë që betejën ta bëj përsëri me Kryebabale Luzim Basha. Ngrini akuza, lëri pyetje! Duhet për në Gjykatë përsëri. Le të na gjykojë në fund publiku. Siç do na gjykojë në Shtator për "Babale 1", e më pas edhe për "Babale 2" etj", tha z.Balla.

Spaho-Ballës: Mos hesht, trego lidhjet me trafikantin ndërkombëtar të drogës

Nënkrjetari demokrat Edmond Spaho përforcoi dje më tepër akuzat e PD-së për lidhje të qeverisë me kriminelin e organizuar. Spaho teksa iu referua arrestimit të biznesmenit të ndërtimit Edmond Bego, përmes një statusi në "Facebook", z. Spaho i kërkon kreut të grupit të deputeteve të PS-së Taulant Balla që mos të heshtë, por të flasë për lidhjet me trafikantin ndërkombëtar të drogës Edmond Bego. "Eshhtë zhdukur mr. Toyota Yaris! Që kur policë t grekë arrestuan trafikantin e rrezikshëm ndërkombëtar të drogës, anëtarin e bandës së Aldo Bares, mr. Toyota Yaris që komenton për çdo gjë, ka kycur gojën papritur! Taulant Balla duhet t'u thotë shqiptarëve menjëherë: Çfarë e lidh atë me trafikantin e rrezikshëm ndërkombëtar të drogës?! Për një përgjigje sa më të kthjellët, mjafton të zbrësë disa kate nga apartamenti i tij dhe si zakonisht, të pije një kafë tek "Hilton"...", shkruan në nënkryetari i PD-së.



Deputeti i PS i kundërpërgjigjet akuzave të PD

Ndreu: Suflerët e trullorur të PD-së kanë lajthitur, e liroi qeveria 'Berisha'

Partia Demokratike e konsideroi biznesmenin Edmond Bego, të arrestuar nga policia greke për llogari të italianëve, si njeri të lidhur ngushtë me pushtetin e Edi Ramës. Por pas akuzave të PD ka ardhur edhe reagimi i parë nga radhët e PS. Deputeti Pjerin Ndreu e ka quajtur lajthitje totale qëndrimin e PD. "Lajthitja totale e një forcë politike që quhet PD është e evidente. Ndërsa bëjnë opozitë, shfaqin simptoma të rënda në interpretimin e ngjarjeve të ndryshme. Të ndërthyer në mllëfin e ekstrem kundër Edi Ramës iu është errur logjika dhe nuk dinë ca thonë! Në pamundësi totale për të përballuar forcën e lidhshimit të PS-së, dalin në konferenca shtypi e thonë çfarë nuk thonë. Rasti i një të ashtuquajturit Mond Bega që na qenka arrestuar në Greqi sipas PD përbën arsye për t'ju vërsu-



lur qeverisë , Edi Ramë s dhe Taulant Ballë s, se paskan ndihmuar këtë të dënuarin! Po mirë PS paska ndihmuar sipas Palokës, Mondin mos të kapet, po në gjykatë kush e ndihmoi që konvertoi dënimin nga 21 në 4 vjet ? Ndërsa PS paska lidhje me Mondin, lidhjen me kryesuesin e kolegjit Penal në Gjykatën e Lartë, njeri i afërt i Berishës dhe i zgjedhur prej tij kush ia bëri ?! Sipas suflerëve të trullorur të PD miqtë e tyre i lehtësuan dënimin dhe e lanë të lirë në gjykatë, ndërsa në PS

kanë faj se nuk e kapi policia ! Zotërinj, ju rroftë kontributi ju dhe derivateve tuaj në gjykatë për ta liruar nga dënimi. Aq me keq kur dhe vetë autoritetet greke e kanë liruar pasi ka tregu pikërisht konvertimet e dënimeve të pjellave tuaja në gjykatë ! E kuptoni sa të pëshitirë jeni, e lironi vetë dhe dilni në foltore e fajësioni të tjerët! Më të lajthitur se kaq s'ke ku gjen! Të fala nga selia e PD së përhumbur", shkruan Ndreu

iane, arrestohet nga policia greke, por jo nga policia shqiptare? Si është e mundur që një trafikant i dënuar droge, jo vetëm nuk arrestohet, por bën i qetë biznes në Shqipëri? A është Taulant Balla, politikani që e ka marrë në mbrojtje trafikantin e drogës dhe bën biznes me të?", deklaroi z.Paloka. Demokratët pohojnë se do t'u

japin përgjigje këtyre pyetjeve në ditët në vijim, por ndërkohë kërkojnë nga prokuroria të hetojë përse policia shqiptare nuk veproi ndaj një personi në kërkim për trafik ndërkombëtar droge. Edi Paloka i bëri thirrje gjithashtu edhe prokurorisë të nisë menjëherë hetimet për moszbatimin e ligjit

duke e lënë të lirë shtetasin e arrestuar duke u shprehur se heshtja e prokurorisë është mbështetje të kriminit të organizuar. "Heshtja e prokurorisë do të jetë një tjetër e dhënë që edhe ky organ tashmë është rreshtisht në mbështetje të kriminit të organizuar dhe jo në luftë me të", u shpreh z.Paloka.

Përmbasuesi Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, njofton shpalljen për shtitje në ankan të Dytë për pasuritë e paluajshme si më poshtë:

- Pasuria Nr. 250/3+1-2, Vol.-31, fq.-234, Z.k-1791, Apartament me Sip.-209.7 m2, ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 5'284'440 Lekë.
- Pasuria Nr. 250/3+1-3, Vol.-31, fq.-235, Z.k-1791, Apartament me Sip.-209.7 m2, ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 5'284'440 Lekë.
- Pasuria Nr.211/11, Vol.- 4, fq.-201, Z.k-1791, llojë Tokë-0Arë me Sip.- 500 m2, ndodhur në Golem Kavajë, me vlerë 280'000 Lekë.

Ankanti për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 23.08.2018,në orën 16.00, në ambientet e zyrës së Përmbasuesit Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, me adresë: Rruga "Urani Pano", Pll-1/3, Kati -2, Tiranë. Cel. 069 73 23 003, email: medar.kajolli@yahoo.com

QEVERISJA KRITIKAT

Rrokaj: Kryeministri vazhdon t'u flasë shqiptarëve për projekte imagjinare e ide në ajër

"Akademia e 100 fshatrave", LSI: Parulla rilindase

"Takimi me të rinjtë, broçkullat e Ramës në Jalë"

Deputeti i Lëvizjes Socialiste për Integrim Shezai Rrokaj komentoi dje në rrjetet sociale iniciativën e kryeministrit me Akademinë e 100 fshatrave turistike. Sipas tij këto janë broçkullat e kryeministrit për "Akademinë e 100 fshatrave". Pak javë pas mbylljes së sesionit parlamentar, kryeministri Edi Rama rini-si para dy ditëve programin e ri politik të qeverisë nga bregdeti, ku mori pjesë në mbledhjen me të rinjtë dhe pedagogët e Akademisë "100 fshatrat". Z.Rama theksoi se ky projekt ndihmon në zhvillimin në disa drejtime të Shqipërisë rurale. Kryeministri u ndal tek bashkëpunimi i qeverisë me Akademinë, por edhe ai i institucioneve. Rama tha se në këtë projekt do të ketë një bashkëpunim edhe me universitetet e huaja, të cilat do të marrin pjesë në këtë projekt. Por për deputetin e LSI-së kryeministri po broçkullis para shqiptarëve. "Ky kryeministër po ua torollit kokën shqiptarëve vetëm me sajesa termash si, bie fjalla, kjo Akademia, apo siç ish-të policia që duam", por nuk doli ajo që deshëm; portali 'mësues për Shqipërinë' që u kthye në mësues për partinë, e shumë parulla të tjera rilindëse si këto. Kjo tregon se kryeministri ynë jo vetëm nuk ia ka heberin nga termi akademi, sepse Akademinë e Shkencave e quajti agjenci funeralesh, por vazhdon e vazhdon t'u flasë shqiptarëve për projekte imagjinare e ide në ajër, shkruan Rrokaj në postimin e tij.



DEKLARATA
"Kjo tregon se kryeministri ynë jo vetëm nuk ia ka heberin nga termi akademi, sepse Akademinë e Shkencave e quajti agjenci funeralesh, por vazhdon e vazhdon t'u flasë shqiptarëve për projekte imagjinare e ide në ajër", - shkruan Rrokaj në postimin e tij.

tij të '100 fshatrave'. Rrokaj i drejtohet z.Rama: "Agriturizmi, zoti kryeministër, lidhet me dy shtylla kryesore si: bujqësia dhe turizmi rural i diversifikuar. Mirëpo edhe ato politika subvencionimi të fermerëve, të ngritura gjatë

qeverisjes së mëparshme, i kenë degraduar. Çfarë turizmi do të zhvilloi Ju, zoti kryeministër, kur, më së pari, fshatrat nuk kanë rrugë, ujë të pijshëm, impiante për ujërat e zeza, ndriçim normal e qendra shëndetësore?

Meqenëse ndodheni në bregdetin e Jonit mjafton të përmendim se, që prej ish-Shkollës së Marinës, ujërat e zeza derdhen në det. Impianti i ujërave të zeza të Radhimës mbeti vetëm në letër".

"Vepër e shtrenjtë dhe e panevojshme"

Projekti rrugor Qafë Thanë- Pogradec, Shehi: I gabuar, me plot rreziqe

Kreu i LZHK-së, deputeti Dashamir Shehu, evidenton disa probleme që ai sheh nga projekti që po vihet në zbatim aktualisht në segmentin e rrugës Qafë-Thanë-Pogradec, konkretisht në pjesën e fundit në hyrje të qytetit të Pogradecit. Sipas Shehit, ky projekt është i gabuar dhe një rrezik permanent për rrëshqitje të reja. "Dy fjalë për një vepër të shtrenjtë dhe të panevojshme. Në të hyrje të Pogradecit po ndërtohet segmenti i fundit i rrugës së re Qafë Thanë-Pogradec, rreth 900 metra gjatë. Pjesa tjetër e rrugës pothuajse ka mbaruar dhe për të qenë të sigurtë është një rrugë e një kualiteti të lartë për standardet tonë të ndërtimit përtej zg-



jatës shumëvjeçare për t'u përfunduar (trotuare, ndriçim, sisteme mbrojtëse metalike, nënkallime). Deri këtu jemi në rregull. Problemi fillon me pjesën e fundit në të hyrje të Pogradecit", shprehet z.Shehi. Ai vë në dukje se "Është bërë një projekt gjigand me katër tunelet të hapura betoni, të ashtuquajtura "panoramike" që kanë kushtuar miliona euro (rreth 12 milionë) thuhet, se

në tabelën treguese nuk ekziston shifra) por njëkohësisht është dashur që të krijohet dhe një skarpate në faqen e malit që për shumë vite do të duket si një gurorë gjigande, përtej faktit që vazhdimisht do të jetë e kërcënuar nga rrëshqitja e malit, siç ka ndodhur tashmë". "Si konkluzion, unë mendoj që është një projekt i gabuar dhe i shtrenjtë (me aq para mund të bëhej i gjithë projekti i ri i sistemimit të zonës nga Pogradeci në Volorekë) aspak ekologjik dhe pa qëndrueshmëri për të ardhmen. Fatqekësisht ky nuk është i vetmi projekt i tillë e mëndje të sëmura dhe situatave korruptive që ka prodhuar "rilindja", tha z.Shehi.



DENONCIMI

Një qytetar nga Puka denoncoi të ish kryeministri Berisha, Kreun e Bashkisë Pukë Gjon Gjonaj për veprime abuzive dhe vendosjen e gjithë qytetit nën "kontrollin" e njerëzve të tij. Në denoncim thuhet se "në krye të dy institucioneve lokale, me një peshë specifike për përmbushjen e qëllimeve ogurzëzë të kryetarit të bashkisë Pukë, janë dy vëllezër; Ndue Nikolli, përgjegjës i OSSHE-së Pukë

Ndoka: Zgjohu Edi Rama! "Byrazeri" yt Erdogan, po ta fut pa e ndjerë

Kreu i PDK-së Nard Ndoka reagoi dje pas lajmeve se universitetin e New York në Tiranë e ka blerë shteti turk. Ai në një shënim në rrjetet sociale shkruan se "Strategjia turke, po pranohet zyrtarisht nga Rama e Thaçi; nënshtrim, çorientim apo tradhti kombëtare?". "Shteti turk blen Universitetin New York në Tiranë. Financim i posaçëm shtetëror për influenca otomane në Kosovë e Shqipëri; në ekonomi, arsim, kulturë, histori e religjion. Strategjia turke, po pranohet zyrtarisht nga Rama e Thaçi; nënshtrim, çorientim apo tradhti kombëtare?! Higet flamuri i SHBA-ve, vendoset flamuri turk! Kërkesa e përsëritur e Erdoganit për Ramën; mbyllja e shkollave të Gylenit, sipërmarrje private. Rama nën frikën e SHBA-ve, zgjodhi një mënyrë të kamufluar: dy rrymat turke, prezente në Shqipëri. SHBA vëzhgon! Zgjohu Edi Rama, "byrazeri" yt Erdogan, po ta fut pa e ndjerë, apo kështu të pëlqen!", shprehet z.Ndoka.

DEKLARATA

"Kërkesa e përsëritur e Erdoganit për Ramën: mbyllja e shkollave të Gylenit, sipërmarrje private. Rama nën frikën e SHBA-ve, zgjodhi një mënyrë të kamufluar; dy rrymat turke, prezente në Shqipëri. SHBA vëzhgon! Zgjohu Edi Rama, "byrazeri" yt Erdogan, po ta fut pa e ndjerë, apo kështu të pëlqen!", shprehet z.Ndoka.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra për bashkëpunim "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 01 tetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë për bashkëpunim do të shqyrtohen ofertat për ankimin e 1-rë për shitjen e pasurisë së "MUSHIQ" shpk të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Pasuria përbehet nga dy dyqanë (gjithej rreth 245 m²) dhe tre apartamente (gjithej rreth 245 m²) dhe mbi këto prona nuk rëndojnë barrë hipotekore apo nuk janë të kufizuara nga detyrime të tjera. Çmimi fillestar për çdo apartament do të jetë 54.000 lek/m², ndërsa çmimi fillestar për dyqanin do të jetë 81000 lek/m². Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000 E-mail: best.2010@perbarues.al, web: www.perbarues.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra për bashkëpunim "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 15 tetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë për bashkëpunim do të shqyrtohen ofertat për ankimin e 1-rë, për shitjen e pasurisë nr.4/ 562/NDNT, me çmim fillestar 7.695.000 lek. Prona me sipërfaqe 95 m² i takon z.Sami Zeqir Zeqija, ajo ndodhet pranë dyqanit të ALBITAL-CANON, Rruga Egnatia,nr.4, Durrës. P.s: Qytetarët/subjektet që dëshirojnë të marrin pjesë në ankim krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të çmimit fillestar si garanci për pjesëmarrje në ankim. Kjo garanci pasurore duhet të jetë e derdher në BKT, nr.ilogarisë Saimir Hoxha PF (IBAN: AL07 2051 2046 4204 98CL PRCLALLA).

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra për bashkëpunim "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 17 shtator 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë për bashkëpunim do të shqyrtohen ofertat për shitjen e pasurisë nr.58/56, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Trualli që ka sipërfaqen prej 600 m² kufizohet sipas një marrëveshjeje sipërmarrje. Prona është e vëllëzërve, z.Arben e z.Shkëlqim Riza Braemta. Çmimi fillestar me të cilin hapet ankimin do të jetë 48735000 lek. Çmimi mund të llogaritet edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditor. Ofertuesit duhet të kenë depozituar në llogarinë e zyrës për bashkëpunim 10% të çmimit fillestar. Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000 E-mail: best.2010@perbarues.al, web: www.perbarues.al

Ja si shpëtoi 38-vjeçari fierak në 21 prill 2018

Shpërthimi në makinën e Ervin Memos, ekspertiza: Tritoli ishte në kroskot, u aktivizua me celular

FIER- Rreth 5 muaj pas ngjarjes së rëndë që tronditi qytetin e Fierit, ku një sasi eksplozivi shpërtheu në makinën e 38-vjeçarit Ervin Memo, del ekspertiza. Ekspertët kriminalistikë, pas ekspertimit të imtësishëm që i është kryer automjetit tip 'Benz' me targa 'AA 270 IV' të shkatërruar thuajse krejtësisht si pasojë e shpërthimit, kanë konkluduar se lënda plasëse gjendej në kroskot, nga ana e pasagjerit dhe se është aktivizuar me anë të një thirrje telefonike. Policia po punon për verifikimin e numrit celular prej nga është kryer thirrja që ka aktivizuar eksplozivin. Ka qenë vendndodhja e ek-

EKSPERTIZA

Ekspertët kriminalistikë, pas ekspertimit të imtësishëm që i është kryer automjetit tip 'Benz', të shkatërruar thuajse krejtësisht si pasojë e shpërthimit, kanë konkluduar se lënda plasëse gjendej në kroskot, nga ana e pasagjerit dhe se është aktivizuar me anë të një thirrje telefonike.

splozivit në kroskot ajo që ka sjellë shkatërrimin e plotë të mjetit si edhe shpëtimin e jetës së Memos. Kujtojmë se 38-vjeçarit ka mundur të dalë me këmbët e tij nga autovetura, e cila u përfshi

e gjitha nga flakët. Mësohet se ekspertët kanë konkluduar që presioni i krijuar nga shpërthimi i eksplozivit të jetë përqendruar në drejtim të ndenjesës së pasagjerit. Ngjarja ndodhi mbrëmjen e

21 prillit të këtij viti, rreth orës 22:45, ku një shpërthim i fortë i ndodhur në lagjen "29 Nëntori" në qytetin e Fierit, pranë vendit të quajtur kryqëzimi i Greqallisë tronditi banorët e zonës. Pikërisht në momentin kur 38-vjeçari Ervin Memo kishte hipur në makinën e tij tip 'Benz', një shpërthim i fortë ka shpërthyer makinën. I riu arriti të dalë nga makina dhe me këmbët e tij kaloi anën tjetër të rrugës. Gjatë shpërthimit ai gjendej në ndenjesën e drejtuesit të mjetit dhe mori



goditje që i sollën vetëm dëmtime në lëkurë por pa pasoja të rënda për jetën. Mënyherë në vendngjarje kanë mbërritur qytetarë të shumtë, forcat e policisë, zjarrfikëset dhe autoambulanca që u bënë dëshmitarë të shpëtimit mrekullisht të Memos. Vetë 38-vjeçari Erv-

in Memo ka deklaruar atëherë para hetuesve se nuk ka asnjë lloj konflikti tjetër veç konflikteve për pronat. Familja e 38-vjeçarit ka trashëguar troje në qytetin e Fierit, pranë unazës së re, ku është ndërtuar edhe një pallat që është në proces legalizimi.

Policia sekuestron kamerat e sigurisë, po punohet për identifikimin e autorit

Grabitet karburanti në Lezhë, plagoset me armë gjatë përleshjes roja

Martin Prenga: Një person i maskuar e me pistoletë, më tha: Lekët!


Ina Allkanjari

LEZHE

Një roje karburanti ka mbetur i plagosur me armë zjarri mbrëmjen e së shtunës në Lezhë, gjatë përleshjes me një grabitës. Ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e së shtunës në rrugën dytësore Lezhë-Rrilë, ku një person i maskuar dhe me armë ka arritur të marrë një shumë parash nga pika e karburantit. Punonjësi i karburantit, Martin Prenga gjatë tentativës për të ndaluar grabitësin ka marrë një plumb në këmbë, ndërsa ky i fundit ka arritur të largohet me një makinë pa targa. Policia po punon për zbardhjen e plotë të ngjarjes, si dhe për identifikimin dhe kapjen e autorit.

NGJARJA

Mbrëmjen e së shtunës rreth orës 22:30, një pikë karburanti e ndodhur në rrugën dytësore Lezhë-Rrilë, ka rënë pre e grabitësve. Një person i maskuar ka hyrë për të vjedhur pikën e karburantit dhe për pasojë ka plagosur në këmbë me armë zjarri pistoletë 50-vjeçarin Martin Prenga, punonjës në karburant, i cili është dërguar menjëherë drejt spitalit të Tiranës, ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Në vendngjarje mbërritën menjëherë forcat e policisë, te cilët u vunë në ndjekje të autorit. Mësohet se grabitësi ka vepruar i vetëm. Policia ka sekuestruar kamerat e sigurisë për të parë nëse mund të bjerë në gjurmët



e autorit. Grabitësi ka mundur të marrë një sasi të konsiderueshme parash dhe është larguar me shpejtësi, por ende nuk është saktësur vlera që i është marrë rojës së pikës së karburantit. "Më datë 18.08.2018, rreth orës 22:50, në aksin rrugor rural Lezhë - Rrilë, tek një karburant, një person për të cilin vazhdojnë hetimet për identifikimin dhe kapjen e tij, ka hyrë për të vjedhur dhe për pasojë ka mbetur i plagosur në këmbë me armë zjarri pistoletë shtetasi M.P. punonjës në karburant, i cili

ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën". thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkohë roja i karburantit, i cili është është transportuar për në Spitalin e Traumës në Tiranës, ku i është dhënë ndihma e pare tregon për ABC News së nuk ka mundur të identifikojë autorin pasi ka qenë i maskuar. "Isha në vendroje. Një person i maskuar me një armë në dorë hapi derën me forcë dhe më tha: Lekët, lekët! Instinktivisht u çova në këmbë. Zgjata dorën të shtypja pulsant-

in e alarmit. Në atë moment personi i maskuar më drejtoi pistoletën. Me dorën e majtë unë i ula tytën e armës, por aty ai qëlloi duke më plagosur në këmbë. Nga ai moment nuk mbaj mend më. Nuk e njoha cili ishte dhe as nuk e kuptova se me çfarë mjeti erdhi apo u largua", është shprehur punonjësi i karburantit Martin Prenga. Sakaq grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, vazhdojnë hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

PUNONJËSI I KARBURANTIT

"Isha në vendroje. Një person i maskuar me një armë në dorë hapi derën me forcë dhe më tha: Lekët, lekët! Instinktivisht u çova në këmbë. Zgjata dorën të shtypja pulsantin e alarmit. Në atë moment personi i maskuar më drejtoi pistoletën. Me dorën e majtë unë i ula tytën e armës, por aty ai qëlloi duke më plagosur në këmbë. Nga ai moment nuk mbaj mend më. Nuk e njoha cili ishte dhe as nuk e kuptova se me çfarë mjeti erdhi apo u largua", është shprehur punonjësi i karburantit Martin Prenga.



Aksident në rrugën Tepelenë-Fier, vdes në spital 33-vjeçari

FIER- Një aksident ka ndodhur gjatë ditës së djeshme në aksin rrugor Tepelenë-Fier pranë vendit të quajtur Qesarat. Një makinë me targa italiane me drejtues shtetasin me iniciale R.K. është përplasur me një motor, ndërsa drejtuesi i këtij të fundit 33-vjeçari me iniciale E.T. është dërguar me urgjencë në spitalin e Gjirokastrës, por nuk ka mundur të mbijetojë. 33-vjeçari do të transportohej me helikopter drejt Tiranës, por nuk ka mundur t'i mbijetë plagëve të marra. Policia ka nisur hetimet për zbardhjen e rrethanave të aksidentit.

NJOFTIM ANKANDI
Me date 17.08.2018 Permbuesja Gjyqësore Ermira Mhilli shpall ankandin për shitjen e pasurisë së palushme e llojit **Ndertesë,Kati i parë i perbers nga dy dhoma bana koridor salton dhe balkon me sip.123 m², me nr.radhori 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne Z.K.8592.Lqj."Naim Givibegu" Rr.Sali Nivica/Shkoder** Cmimi fillestar për Shitjen ne Ankand eshte ne vleren **5,707,200 leke (Pesë milion e shtatëqind e shtata mila e dyqind leke)** Shitja e pasurisë do te behet,(zhvillohet) ne ambientet e Zyrës se Permbueses Gjyqësore Ermira Mhilli,me adrese Lqj."Qemal Stafa",Rr."Don Bosko", dhe do te perfundoje me dt.16.09.2018 ora 16:00 (me perfundimin e orarit zyrtar) **Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Banken Raiffeisen-Dega Shkoder** Çfiteruesit te drojtohen pranë Zyrës se Permbueses Gjyqësore Ermira Mhilli ,ose te kontaktojnë nepermjet Nr.tel 0692219253 ose adreses se emaili. **ermira.mhilli@hotmail.com**

NJOFTIM ANKANDI
Me date 17.08.2018 Permbuesja Gjyqësore Ermira Mhilli shpall ankandin për shitjen e pasurisë së palushme e llojit **Ndertesë, Kati perdersha pa ndarje,Dyqan me sip.113 m², me nr.radhori 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne Z.K.8592.Lqj."Naim Givibegu" Rr.Sali Nivica/Shkoder** Cmimi fillestar për Shitjen ne Ankand eshte ne vleren **4,718,880 leke (Kater milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mila e tetëqind e tetëshata)** Shitja e pasurisë do te behet,(zhvillohet) ne ambientet e Zyrës se Permbueses Gjyqësore Ermira Mhilli,me adrese Lqj."Qemal Stafa",Rr."Don Bosko", dhe do te perfundoje me dt.16.09.2018 ora 16:00 (me perfundimin e orarit zyrtar) **Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Banken Raiffeisen-Dega Shkoder** Çfiteruesit te drojtohen pranë Zyrës se Permbueses Gjyqësore Ermira Mhilli ,ose te kontaktojnë nepermjet Nr.tel 0692219253 ose adreses se emaili. **ermira.mhilli@hotmail.com**

EPSA SHOOËRIA PERMBUESË PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR :
1- "Pylil + Kullote" me sip. 280.000 m², Nr. hipotekor 168 date 29.05.2012, ZK 3028, e ndodhur ne Porto, Vlore. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. Cmimi me te cille fillon ankandi eshte **3.360.224 Euro** . Ankandi zhvillohet date **07.09.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratri", K.6,Tirane.
2- "Pylil + Kullote" me sip. 95.000 m², Nr. hipotekor 66 date 25.03.2009, ZK 3028, e ndodhur ne Porto, Vlore. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. Cmimi me te cille fillon ankandi eshte **1.140.076 Euro** . Ankandi zhvillohet date **07.09.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratri", K.6,Tirane. Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne **www.epsa.al**

Dyshohet se ndodhjet në automjet, shpallet në kërkim Zyber Bami, i afërm i Durim Bami

Ina Allkanjari

Pas incidentit të ndodhur disa ditë më parë në rrugën "Jordan Misja" në kryeqytet, ku dy të rinj qarkullonin me armë zjarri dhe nuk iu bindën urdhrat të Policisë për të ndaluar, gjykata e Tiranës ka dhënë masën e sigurisë. Ndaj 25-vjeçarit Gentjan Koçi dhe 33-vjeçarit Ervin Kodra të cilët akuzohen për "Kundërshtim të policisë" e "Armëmbajtje pa leje" u dha masa e sigurisë "arrest me burg". Gjatë ndjekjes së policisë, drejtuesi i automjetit Gentjan Koçi ka përplasur 4 automjete të tjera në rrugë, duke shkaktuar vetëm dëme materiale.

Gjithashtu, mësohet se në makinën e të dyshuarve ndodhjet edhe një person i tretë, i cili është shpallur në kërkim. Bëhet fjalë për shtetasin Zyber Bami, dhe rezultoi të jetë i afërm i Durim Bami. Ky i fundit, njihet si atentatori i rremë i çështjes "Doshi".

NGJARJA

Mbrëmjen e 16 gushtit rreth orës 23:20, Policia e Tiranës ka evidentuar dhe goditur një tjetër rast të armëmbajtjes pa leje dhe mosbindjes së punonjësve të policisë për të ndaluar,

Incidenti me "Tuareg"-un në Tiranë, lihen në burg Gentjan Koçi dhe Ervin Kodra

Qarkullonin me armë, të rinjtë përplasën 4 makina në përpjekje për t'u arratisur



Gentjan Koçi dhe Ervin Kodra ditën e djeshme në gjykatën e Tiranës

ku falë punës së mirëorganizuar dhe ndjekjes nga ana e shërbimeve të policisë, kapen dhe arrestohen drejtuesi i mjetit dhe pasagjeri. Gjatë ndjekjes nga policia të automjetit ku udhëtonin dy shtetasit që mbanin armë zjarri me

vetë, drejtuesi i automjetit ka përplasur duke u shkakuar dëme materiale 4 automjeteve të tjera. Policia gjeti dhe sekuestroi dy armë zjarri të tipit "Pistoletë", të cilat u hodhën në një oborr banese dhe në një rrugicë nga drejtuesi i

HETIMI

Gjithashtu, mësohet se në makinën e të dyshuarve ndodhjet edhe një person i tretë, i cili është shpallur në kërkim. Bëhet fjalë për shtetasin Zyber Bami, dhe rezultoi të jetë i afërm i Durim Bami. Ky i fundit, njihet si atentatori i rremë i çështjes "Doshi".

tjan Koçi, 25 vjeç, banues në Tiranë; Ervin Kodra, 33 vjeç, banues në Tiranë.

"Këta shtetas në rrugën "Jordan Misja", duke lëvizur me mjetin tip "Tuareg", i cili drejtohej nga shtetasi Gentjan Koçi dhe pasagjer shtetasi Ervin Kodra, nuk i janë bindur shenjës së ndalimit të shërbimit të "Forcës së Posaçme Shigjeta", pasi mbanin sende të kundërligjshme në mjet (2 armë zjarri pa leje), por janë larguar me shpejtësi me mjet, duke u bërë burim aksidenti e duke u përplasur edhe me 4 mjete të tjera në rrugë duke iu shkakuar dëme materiale dhe pas ndjekjes nga ana e shërbimeve të policisë këta shtetas janë ndaluar në rrugicat e rrugës "Jordan

Misja", ku dhe u bë arrestimi në flagrancë i tyre", thuhet në njoftimin e policisë. Gjithashtu, nga ana e shërbimeve të Policisë janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 2 armë zjarri të lojit "Pistoletë", të hedhura prej shtetasve të lartpërmendur pasi braktisën mjetin, në oborrin e një banese dhe në një rrugicë. Materiali i referuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur për veprat penale "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak", "Shkatërrim prone" dhe "Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të Policisë".



Save the Children

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne besojmë se çdo fëmijë meriton një të ardhme të mirë. Në botë dhe në Shqipëri, ne ndihmojmë fëmijët të kenë një fillim të mbarë në jetë, mundësi për të mësuar dhe mbrojtje ndaj çdo rreziku. Ne bëjmë më të mirën për fëmijët - çdo ditë dhe në kohë krize - për të sjellë ndryshime në jetën e tyre dhe të ardhmen e përbashkët. Ne jemi duke kërkuar staf të kualifikuar dhe aktiv për t'u bashkuar me ekipin tonë.

Save the Children do të rekrutojë staf të motivuar dhe me përvojë për projektin "Përfshirja e Shoqërisë Civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri"

Titulli i pozicionit:
Afati i fundit për aplikim:

Koordinator i Granteve
20 Gusht 2018, 16:00

Kandidatët që kanë kualifikimet dhe përvojën, e përshkruar si më poshtë, inkurajohen të aplikojnë.

- Diplomë Bachelor në Administrim Biznes, Financë ose Juridik. Diplomë Master në një nga këto degë përbën avantazh.
- Minimumi 5 vjet përvojë pune kryesisht në OJF/organizata ndërkombëtare.
- Përvojat e mëparshme me projektet PRAG / BE.
- Aftësi të shkëlqyera kompjuterike, duke përfshirë: Microsoft Word, Excel të avancuar, Internet, Email dhe Power Point dhe menaxhim të dhënash.
- Të gatshëm për të udhëtuar në terren.
- Përvojë pune me organizatat partnere
- Të kuptuar dhe përkushtim ndaj qëllimeve dhe objektivave të Save the Children dhe të drejtave të fëmijëve në Shqipëri

Ju do të gjeni më shumë informacion për Përshkrimin e Punës në faqen e internetit <https://albania.savethechildren.net/jobs>

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar, si më poshtë, brenda datës 20 Gusht 2018:

- 1- Letër motivimi ku shpjegoni qartë arsyen tuaj për aplikim dhe mënyrën se si i përmbushni kriteret;
- 2- CV e detajuar;
- 3- Kopje të Diplomës tuaj.

Aplikimi duhet të dërgohet në anglisht me email në adresën e mëposhtme. Ju lutem specifikoni qartë pozicionin për të cilin po aplikoni.

E-mail: info.albania@savethechildren.org
*vetëm kandidatët e përzgjedhur do kontaktohen

Save the Children in Albania
Rr. Komuna e Parisit, Lagja 8, Pallatet 1 Maj,
Vila "Lumi", P.O. Box 8185, Albania
Phone: +355 4 2261840/+355 42261829/+355 4
2266227
E-mail: info.albania@savethechildren.org
Web Page: albania.savethechildren.org

Save the Children International
St Vincent House
30 Orange Street
London WC2H 9HT
United Kingdom

A company limited by guarantee.
Registered charity number 1076822
Registered company number
3732267
Registered in England and Wales

Telephone +44 (0) 20 3272 0300
Fax +44 (0) 20 3272 0301
info@savethechildren.org
www.savethechildren.net



Save the Children

VACANCY ANNOUNCEMENT

Save the Children is the world's leading independent organization for children. We work in 120 countries. We save children's lives; we fight for their rights; we help them fulfil their potential. We work together, with our partners, to inspire breakthroughs in the way the world treats children and to achieve immediate and lasting change in their lives. We have been working in Albania since 1999. We are looking for dynamic staff to join our team.

Save the Children is recruiting for motivated and experienced staff for the project "Civic engagement for a functional judiciary system and access to justice in Albania"

Post title: **Sub-Grant Coordinator**
Application dateline: 20 August 2018, 4:00pm

Candidates that meet below qualifications and experience are encouraged to apply.

- A Bachelor degree in relevant subject from an accredited University in Business Administration, Finance or Law. Master in relevant subject.
- Minimum 5 years of relevant work experience, preferably in an NGO/international organization.
- Previous experience with PRAG/EU projects.
- Excellent computer skills including: Microsoft Word, advanced Excel, Internet, Email and Power Point and demonstrated computer literacy & database management.
- Willing to travel in the field.
- Experience in working with partner organisations.
- Understanding and commitment to the aims and objectives of Save the Children and children's rights in Albania

You will find more information for the Job Description on the web page <https://albania.savethechildren.net/jobs>. Interested candidates should submit the following within the application dateline:

- 1- Cover letter clearly explaining your motivation for applying your motivation for applying for the position and how you meet the position criteria;
- 2- Detailed CV;
- 3- Copy of their Diploma.

Application should be sent by email to the address below. Please clearly specify in the subject line or in the cover letter the position you are applying for.

E-mail: info.albania@savethechildren.org

*only short listed candidates will be informed.

Save the Children in Albania
Rr. Komuna e Parisit, Lagja 8, Pallatet 1 Maj,
Vila "Lumi", P.O. Box 8185, Albania
Phone: +355 4 2261840/+355 42261829/+355 4
2266227
E-mail: info.albania@savethechildren.org
Web Page: albania.savethechildren.org

Save the Children International
St Vincent House
30 Orange Street
London WC2H 9HT
United Kingdom

A company limited by guarantee.
Registered charity number 1076822
Registered company number
3732267
Registered in England and Wales

Telephone +44 (0) 20 3272 0300
Fax +44 (0) 20 3272 0301
info@savethechildren.org
www.savethechildren.net

24-vjeçari: Kam shpresë vetëm 1% se gjërat do ndryshojnë, jam totalisht i humbur

Senad Nikshiqi

Jam shkatërruar nga droga dhe kam shkatërruar jetën e familjes". Riad Celufaj dhe fjalët që thotë janë historia e jetës së tij. 24 vjeçari nga Shkodra tregon dashurinë dhe luftën me drogën, betejë që herë e ka fituar dhe herë e ka humbur. Ai e nisi drogën kur ishte vetëm 18 vjeç duke përdorur heroinë ndërsa sot ndodhet mes shumë vështirësive. I riu shkodran tregon përmes një interviste rrugëtimin e jetës së tij deri sot në ditët më të këqija me shpresën se tashmë do të nisë një kapitull i ri. Rrugëtimi me drogën për Riadin nuk ishte asgjë tjetër veçse një shkatërrim. Vjedhje, borxhe, mashtrim, ndarje nga familje, ndarje nga miqtë dhe të gjitha këto të lënë të kuptosh se 24-vjeçari ka prekur fundin. Por Riad Celufaj për fat të mirë prej 6 muajsh ka gjetur forcë dhe është shkëputur nga përdorimi i drogës. Sot më shumë se kurrë ky 24 vjeçar ka nevojë për të gjithë, për familjen, për shokët, për shoqërinë dhe akoma më shumë për shoqatat, institucionet apo individë që kujdesen për këtë shtresë personash. Rrëfimi i Riadit nuk mbaron me kaq. Ka diçka shumë të rëndësishme për t'i thënë të gjithë të rinjë shkodran dhe jo vetëm që rrezikojnë të bien në kurrizin e përdorimit të drogës. Riad Celufaj gjeti forcën duke kërkuar publikisht ndihmë.

Riad si e ke nisur përdorimin e drogës?
Unë e kam nisur që kur isha 18 vjeç. Në atë kohë shokova në një sallë lojërash dhe aty takova rastësisht një person. Ai ishte përdorues dhe duke ndenjur me të e mësova edhe unë. Që atëherë më janë bërë 6 vite që unë përdor heroinën derisa kam arritur në këtë ditë që kam humbur gjithçka dhe kam nevojë për ndihmë. Jam në një situatë të keqe ndërsa kam vetëm 1% shpresë, 99% jam i humbur.

Si ke arritur që ta sigurosh heroinën duke qenë se je i papunë?

Fillimisht merrja para në shtëpi si çdo i ri. Më pas kam filluar që të marr borxhe kudo dhe nuk i ktheja më paratë në shumicën e rasteve. Pas borxheve tek të afërmit kam nisur të marr borxh në shokë dhe më pas tek të njohur të tjerë. Pas borxheve disa herë jam detyruar të vjedh paratë e shtëpisë ose kam shitur orëndi apo gjëra të tjera të shtëpisë.

Po jashtë shtëpisë ke vjedhur?

Fatqësisht disa herë po. Kam vjedhur, sepse më duheshin paratë për të siguruar dozën e heroinës.

Sa para të duheshin dhe sa doza ke përdorur zakonisht gjatë ditës?

Minimumi më duhej një

"Droga më shkatërroi jetën, më braktisën të gjithë, më ndihmoni!"

Riad Celufaj: Përdor heroinë prej 6 vitesh, kam humbur gjithçka



24 vjeçari Riad Celufaj



dozë që bën 30 mijë lekë të vjetër. Normalisht një përdoruesi të rregullt i duhet të paktën dy doza në ditë. Unë kam arritur të përdor edhe 5 doza dhe më pas kam qëndruar me nga 3 ditë i shtrirë, sepse nuk kam qenë në gjendje që të cohem.

A ke tentuar që të punosh ndonjëherë?

Kam tentuar dy herë, por kam qëndruar shumë pak. Është shumë e vështirë që të punosh, sepse ta kërkon trupi dhe e kisha të pamundur. E kam lënë punën dhe shpesh i kërkoja paratë paradhënie pronarëve dhe derisa ata e kanë kuptuar.

Me kë jeton aktualisht?

Unë momentalisht jam krejt i vetëm. Babai më ka vdekur para pak kohësh. Nëna me dy vëllezërit dhe motrën janë larguar prej 9 muajsh në Francë dhe më kanë braktisur me të drejtë. Unë kam bërë shumë të këqija dhe ata nuk e meritojnë ndaj kanë krejtësisht të drejtë. Edhe shokët apo të afërmit e të njohur më kanë braktisur për shkak të borxheve dhe problemeve tjera dhe duke parë se përdorja drogën gjithë kohën.

Nuk ke komunikuar gjatë 9 muajve me nënën dhe të tjerët?

Jo nuk më kanë lejuar dhe përgjigja e tyre është që unë duhet të kthehem në rrugën e duhur. Nëse kthehem atëherë pas 5 vitesh a 10 vitesh mbase familja rikthehet tek unë. Unë i kuptoj dhe ata kanë të drejtë. I kërkoj falje për gjithçka atyre dhe gjithë të tjerëve.

Me çfarë je marrë para

se të nise drogën?

Kam qenë një djalë i shkatërrtë them. Kam qenë boksier, kampion me të rinjtë dhe sapo kalova tek të rriturit nis drogën dhe u shkëputa nga sporti. Kam lënë shkollën e mesme pasi nisa një punë me idenë se do e merrja më pas shkollën dhe doja të përqendrohesha të puna. Shumë shpejt nisa drogën dhe lashë edhe punën dhe shkollën se fillova më.

Vazhdon që ta përdorësh heroinën?

Jo unë kam 6 muaj që jam shkëputur dhe nuk e përdor më heroinën.

Çfarë kërkonin ju aktualisht në këtë gjendje që je?

Ajo që kërkoj është një ndihmë nga të gjithë ata që kanë mundësi. Kërkoj të më ndihmojnë shoqatat që janë në Shqipëri, institucionet apo kushdo tjetër që ka mundësi, sepse tashmë kam mbetur krejt i braktisur dhe kam kuptuar se çfarë kam bërë.

Si e sheh zgjidhjen për të ardhmen e jetës tënde?

Unë dua që të tregohem i singurtë. Ajo që më kanë rekomanduar edhe doktorët është që të largohem nga Shqipëria në një shtet tjetër sepse edhe doktorët ma kanë thënë që persona si unë është e vështirë të qëndrojnë aty ku kanë përjetuar vuajtjet dhe problemet e mëdha për shkak të drogës. Kështu që nëse dikush ka mundësi të më ndihmojë që të largohem nga Shqipëria ose të më gjejnë një punë të rregullt që të nisë një jetë të re.

Gjatë 6 viteve që ke përdorur heroinën ka qenë e vështirë ta sigurosh në Shkodër?

Jo nuk është e vështirë. Janë disa persona që e kanë. Ata e pinë edhe vetë, por edhe e shesin për të fituar para. Më shumë janë dorë e dytë ose e tretë. Nuk është se kanë sasi të mëdha, thjeshtë e shpërndajnë.

Çfarë ndjesie të jep?

Të jep adrenalinë dhe pasi e përdor atë të jep shumë oratori. Të duket sikur të gjithë e kanë gabim

dhe vetëm t'i ke drejtë dhe gjen çdo mënyrë për t'i dhënë të drejtë vetes.

Po kur nuk e përdor nëse nuk ke para në një moment?

Faktikisht një përdorues gjithmonë e gjen mënyrën për të siguruar paratë për dozat. Megjithatë mund të ketë ndonjë rast që mbet keq. Atëherë ke dhimbje të madhe të kokës, të gjithë trupit dhe gjithçka bëhet e padureshme. Ke dhimbje të madhe kockash dhe të zien i gjithë trupi.

Sa persona mund të jenë në Shkodër përdorues të heroinës?

Të paktën aq sa njoh unë janë 40 persona në total përdorues të heroinës dhe të gjithë na njohin në ambulancë, sepse kemi qenë disa herë.

Po në shkollë a ke ndonjë ide a përdoret droga?

Po nga sa kam dijeni të rinjtë e përdorin shumë. Normalisht jo heroinën, por përdorin shumë hashash. Kam parë edhe 12 vjeçar ndërsa 15-16 vjeçarët në shkollë tashmë janë të zakonshëm që e përdorin.

A keni një mesazh për ata të rinj që sapo kanë nisur të përdorin drogën?

I lutem që ta lënë sa më parë dhe t'i qëndrojnë sa më larg. Mjafton të më shohin mua se ku kam mbërritur dhe se si jam katandisur duke humbur thuajse gjithçka. Kam shpresë vetëm 1% se gjërat do ndryshojnë dhe 99% jam totalisht i humbur sepse nuk kam asnjë përkahe. Edhe kur i shoh të rinjtë mundohem me fjalët e mia që t'i tregoj historinë time dhe t'i them që t'i qëndrojnë sa më larg drogës, sepse do t'i mohojë edhe familja, siç më ka mohuar mua bashkë me gjithë rrethin shoqëror.

Abuzuan seksualisht me të mitur në dijeni të nënës, publikohen fotot e dy shqiptarëve në Greqi

GREQI- Dy pedofilë shqiptarë janë arrestuar nga policia greke për abuzim ndaj të miturve në Makrohor, Veria. Si të dyshuar për ngjarjen policia e Selanikut vuri në pranga këtë të shtunë, 24-vjeçarin Altin Gega. 22-vjeçarin Jorgo Bulicko dhe të moshuarin grek Dhimitri Panitsidi 83 vjeç. Altin Gega lindi në Shqipëri më 21 janar 1994 dhe Jorgo Bulicko lindi më 18 shtator 1996 në Shqipëri së bashku me një të moshuar grek abuzonin ndaj të miturve në periudhën 2016-2017. Policia bën të ditur se Altin Gega kishte lidhje me nënën e të miturve. Jorgo Bulicko ish-



te shoku i tij, ndërsa i moshuari shkante me pagës. Të gjitha veprimet ndodhën në dijeni të nënës së të miturve. Të tre pedofilët dhe nëna janë arrestuar dhe po kryejnë dënimin. Policia ka vendosur të publikojë emrat dhe fotot e tre

personave në përpjekje për të ndihmuar qytetarët që mund të kenë denoncime, për ngacim dhe vepra të turpshme të ngjashme nga të njëjtët të dyshuar. Të dyshuarit akuzohen për veprat penale krime seksuale dhe shfrytëzim seksual.

Mjeku endokrinolog: Reforma në sistemin shëndetësor, "ilaçi" i vetëm për situatën e krijuar

Voltiza Duro

Shefqet Deliallisi: 175 mjekë të larguar nga Shqipëria në 2017-ën

"Pagat e ulëta e konfliktualiteti me pacientët, faktorët kryesorë"

Vitet e fundit po vihet re tendenca e largimit të bluzave të bardha nga Shqipëria, të cilët zgjedhin të braktisin vendin dhe të ushtrojnë profesionin e tyre në një shtet tjetër. Sipas statistikave, në vitin 2017, numri i mjekëve të larguar ka arritur në 175, që kryesisht janë specialistë apo të rinj. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", mjeku endokrinolog, Shefqet Deliallisi tregon se aktualisht po largohet pjesa më cilësore e mjekëve shqiptarë, e vendi po humb një pasuri të çmuar, të pazëvendësueshme. Më tej ai shton se pasiguria për të ardhmen, pagat e ulëta, presioni, konfliktualiteti me pacientët, pamundësia e karrierës sipas aftësisë, politizimi i saj, janë shkaqet kryesore të ikjes së bluzave të bardha.

Sa është numri i mjekëve shqiptarë të larguar deri më tani nga Shqipëria?

Urdhri i Mjekut ka kohë që jep alarmin. Referuar statistikave të tyre, mjekët po largohen nga Shqipëria me shifra në rritje çdo vit. Nga 76 në vitin 2013, në 175 mjekë të larguar në 2017, kryesisht mjekë të rinj dhe mes tyre dhe mjekë specialistë. Dhe kjo tendencë vazhdon. Mjekët e rinj i kanë lënë librat e mjekësisë, në duar kanë vetëm metodat e gjuhës gjermane... Problemi është i madh. Po humbim një pasuri kombëtare të pazëvendësueshme. Një mjek do 10 vjet të formohet, e për më tepër, po largohet pjesa më cilësore.

Pse po largohen masivisht mjekët nga vendi, cilët janë disa prej faktorëve që i shtyjnë të ushtrojnë profesionin në një shtet tjetër?

Pasiguria për të ardhmen, pagat e ulëta, presioni, konfliktualiteti me pacientët, pamundësia e karrierës sipas aftësisë, politizimi i saj, të gjitha bashkë janë shkaqet e largimit të mjekëve sot. Shumë njerëz e kanë të vështirë të ndahen nga historitë legjendare, sentimentale dhe romantike për mjekët, por kohët kanë ndryshuar. Sloga: net e një epoke s'mund të aplikohen në një tjetër shumë të ndryshme. Sot flitet për industrinë e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor që prodhon shëndet. Politikat publike gjithnjë e më shumë po ndërtohen në terma ekonomike. Kërkesë - ofertë, konkurrencë, kosto-efektivitet, spital ndërmarrje. Reklamë për spitalet, për mjekët, për medikamentet, për procedurat shëndetësore janë normale. Pacientët konsiderohen klientë.

Sa ekziston mundësia që këta mjekë që largohen të specializohen jashtë dhe më tej të rikthehen në Shqipëri?

Kjo vështirë të ndodhë! Ata mund të vinë thjesht si vizitorë, siç dhe ndodhi para disa vitesh kur i ftoi qeveria. Një konferencë, një darkë e



Mjeku endokrinolog, Shefqet Deliallisi

këndshme dhe u kthen nga erdhën, në vendin e tyre të punës jashtë Shqipërisë. Problemi mbetet tek ne. Mendoni çfarë do të ndodhë pas 10-15 vitesh kur brezi i mjekëve të aftë, për arsye moshe, do të tërhiqet? Çfarë do bëhet me spitalet publike? Me largimin e mjekëve më të mirë drejt Europës, apo spitaleve private, sektori publik do të mediokrizohet, qendra universitare po ashtu...

Sa të kënaqur janë bluzat e bardha me pagesat? A pranojnë ende rryshfete?

Shteti i varfër postkomunist, i pamundur për t'i dhënë mjekëve pagën që meritonin, heshiturazi pranoi plotësimin e pagës së tyre nga vetë pacientët, por pa e ligjzuar atë. Sigurisht ishte dhe inteligjenca e pacientëve që kuptuan rëndësinë e problemit dhe e pranuan këtë zgjidhje. Shumë prej tyre, emigrantë në vendet perëndimore, kishin provuar koston e lartë të shërbimit shëndetësor, kishin parë edhe nivelin e shpërblimit të mjekëve atje, dhe kjo ndikoi në pranimin dhe zbatimin e kësaj "marrëveshje". Ishte pikërisht kjo "marrëveshje" që mbajti mjekët në Shqipëri dhe bëri që truri i mjekësisë të mos largohej nga vendi. Ka patur disa përplekje në vite për të kryer një reformë të personelit në shëndetësi, për t'i dhënë fund pagesave informale, por pa sukses. Qeveritë njëra pas tjetrës, kanë mbyllur sytë duke lejuar pagesat informale nga pacientët,

si mjet pagese për mjekët. Por, nga ana tjetër, herë pas here, në kuadrin e luftës kundër korrupsionit, kanë sakrifikuar mjekë me forma policore, duke dëmtuar rëndë figurën e mjekut, duke ushqyer krijimin e një klime konfliktuale, që gradualisht po i heq sistemit shëndetësor gurin e themelit vendosur shekuj më parë: marrëdhënien e besimit, respektit dhe partneritetit mjek-pacient, pa të cilin mjekësia nuk mund të funksionojë.

Mjekësia nuk është thjesht profesion, por një mision për ata që e zgjedhin ta ushtrojnë. PAGESAT informale a bien ndesh me Betimin e Hipokratit, altruizmin që duhet të karakterizojë mjekët?

Duhet të jemi realistë. Që në vitin 1967, Gordon McLean, ekspert i shquar në Kujdesin Shëndetësor Britanik shkruante: "Një nga kërkesat politike madhore të shumicës së shoqërive perëndimore sot është shmangia dhe vlerësimi në mënyrë kritike, i dogmave dhe kllisheve me të cilat është e mbushur politikëbërja për kujdesin mjekësor." Shkenca ekonomike pak i konsideron ndjenjat dhe humanizimin që karakterizojnë praktikimin e mjekësisë. Nuk ka vend për mite. Mjekët janë altruistë, aq sa profesionistët e tjerë. Altruizmi nuk fitohet me një diplomë mjekësia, ai është i lindur. Miti tjetër: "Mjekësia nuk është profesion por mision"! Po të ishte vërtetë mis-

ion, misionarët mjekë s'do lakmonin të gjithë të punonin në qendra të mëdha urbane, mundësisht të gjithë në Tiranë. S'do kishte asnjë fshat pa mjek! Duhet ta shohim të vërtetën në sy. Si gjithë qeniet e tjera njerëzore, edhe mjekët janë homoeconomicus. Askush në një vend demokratik nuk mund të detyrojë dikë të punojë pavarësisht pagës. Është e papranueshme që një mjek specialist me eksperiencë 30 vjeçare të paguhet vetëm 350 euro në muaj. Mentaliteti komunist: mjekët "shërbëtorë të popullit" është i papranueshëm. Vërtet mjekët shërbëjnë, madje i shërbëjnë njerëzve në ditë më të vështira, por s'mund të konsiderohen kurrsesi si shërbëtorë pa dinjitet...

Cila mendoni se është zgjidhja më e mirë për të përmirësuar situatën?

Duke përdorur terma mjekësore, duhet të qartësojmë se pagesa informale (korrupsion) është simptoma e sëmundjes dhe jo vetë sëmundja. Sëmundja e vërtetë është mungesa e reformimit të sistemit shëndetësor. Dhe duke përdorur përsëri terminologjinë mjekësore, për kurimin e sëmundjeve ka dy lloj mjekësi: ai simptomatik, ku mjeku përpiqet të luftojë simptomat, por jo shkakun, mjekim ky që nuk e shëron, por vetëm e lehtëson për kohësisht gjendjen; dhe mjekimin etiologjik, që lufton shkakun, zhduk sëmundjen dhe shëron pacientin. Në rastin tonë duke luftuar korrupsionin (pagesat informale), që është vetëm simptomë e sëmundjes, me "ilaçin" kamera e fshëhtë, denimit, burgosjet demonstrative të mjekëve, sëmundja nuk shërohet, ajo veçse përmirësohet për fare pak kohë, për të vazhduar... E



Përfundon ndërtimi i dy rrugëve të reja te 'Devoja e Ujit' në Tiranë

Bashkia e Tiranës ka përfunduar punimet për ndërtimin e dy rrugëve në zonën e "Devos së Ujit" në Njësinë 2 në kryeqytet. Rrugët përfshijnë kanalizime, shtrim rrjeti të telefonisë, ndriçim dhe sinjalistikë. Dy rrugët që të çojnë në këtë zonë vijnë si zgjatim i rrugëve "Budi" dhe "Mihal Grameno". Teksa inspektori rrugët e reja, kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, i shoqëruar nga deputetja Vasilika Hysi, theksoi se e gjithë zona që deri një vit më parë i ngjante një monopati, tashmë është e urbanizuar. Kreu i Bashkisë u shpreh se bashkëpunimi që Bashkia e Tiranës ka me qeverinë qendrore, për legalizimin dhe urbanizimin e këtyre zonave deri dhe informale, është mënyra më e mirë për të ecur përpara. Në gjithë kryeqytetin, Bashkia e Tiranës ka hapur 100 kantiere ndërtimi, ku një pjesë e tyre tashmë kanë filluar të mbyllen, duke u ofruar qytetarëve që kthehen nga pushimet një infrastrukturë moderne.

AKU asgjëson mbi 1 mijë litra birra e çokollata

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka nisur aksionin në marketet e zonave rurale duke bërë të mundur ndalimin e tregtimit të ushqimeve jashtë kriterëve të sigurisë ushqimore. Sipas këtij dikasteri, gjatë kontroleve të ushtruar nga trupa inspektuese deri më tani janë evidencuar 3 subjekte në Lushnjë, Gramsh dhe Kukëz të cilët kryenin veprimtari në kundërshtim të plotë me ligjin e sigurisë ushqimore. Për këtë arsye, ndaj subjekteve është marrë masa administrative gjobë si dhe konfiskim e asgjësim të produkteve ushqimore. Më konkretisht është bërë asgjësimi i 8 litrave qumësht, 1032 çokollatave, 833 litrave birra, 95 litra lëngje si dhe produkte të tjerë të paketaut. Sipas AKU, këto kontrole do të vazhdojnë të jenë intensive për të mos lejuar askënd të cenojë sigurinë dhe cilësinë e produkteve.

SHFALLJE ANKANDI
Datë 21.08.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel: 40456426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Spitali ankanandi e parë për pasuritë e paluajtshme të dorëzueshme Petrit Sami Sina dhe Majlinda Xhavit Sina:
"Aparamenti" me sipërfaqe 54 m², nr. pasurisë 11/26-1/7, zona kadastrale 2932, vol. 14, faqe 26, adresa Laga "Gigë Dog", Peshkopi, Dibër.
Çmimi fillestar i ankanandit të parë është në shumën 1 600 000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

PENSIONET E USHTARAKËVE MASA E PËRFITIMIT

ISSH sjell shembujt konkretë: Kujdes, ja formula e saktë e përlogaritjes

Voltiza Duro

P prej 1 korrikut, ushtarakëve iu ka lindur e drejta e përfitimit të rritjes së pensionit në masën e indeksuar prej 2.8%. Ky indeksim do të bëhet në bazë të rishikimit të ligjit "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji. "Këshilli i Ministrave vendosi indeksimin, në masën 2.8 për qind, të: pensioneve të caktuara me dekrethin nr.758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut"; trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënofficerë, lundruar të nëndetëve dhe palombarëve të forcave detare në pension", -thuhet në vendim. Më tej në këtë të fundit bëhet me dije se nga kjo rritje do të preken edhe trajtimet e veçanta financiare

Vendimi: Rritje pensionesh për ushtarakët, sa do të përfitojnë

Cilat janë kategoritë që do të marrin më shumë para



të caktuara sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake". Ndërkohë indeksimin, e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.7.2018 e në vazhdim, me kusht që data e

fillimit të pensionit të jetë deri më 30.6.2018, përshirë edhe këtë datë. "Shuma bazë e pensionit, e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duke filluar nga data 1.7.2018 e në vazhdim të

jetë 7 262 lekë. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përlogariten në shumën 1 545 000 000 lekë dhe përballohen nga fondet për politikën e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e ISSH-së të vitit 2018", -nënvizohet më tej në vendim.

FORMULA E LLOGARITJES

Llogaritja e një pensioni suplementar të pleqërisë bëhet sipas formulës: $PSP = PMRMN \times VSH \times 1\%$ ku PSP nënkupton pensionin Supplementar të Pleqërisë; PMRMN është Paga Mesatare Referuese Mujore Neto; ndër-
sa VSH janë vitet e Shërbimit. Por

masa që rezultojnë nga kjo formulë nuk duhet të jetë më shumë se 50 për qind e pensionit të pleqërisë. Nëse një ushtarak përfiton pension pleqërie sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar,

dhe masën 26,000 lekë në muaj; ai ka 28 vite shërbimi si ushtarak dhe pagë mesatare referuese mujore neto 53,700 lekë në muaj. Llogaritja e pensionit suplementar të pleqërisë bëhet në këtë mënyrë: $PSP = 53,700 \text{ lekë} \times 28 \text{ vite} \times 1\% = 15,036 \text{ lekë} / \text{muaj}$. Por, pensioni suplementar i pleqërisë nuk duhet të jetë më i lartë se 50% e pensionit të pleqërisë që ushtaraku gëzon, në çastin e lindjes së të drejtës së pensionit suplementar. Kështu ushtaraku përfiton pension pleqërie në masën 26,000 lekë/muaj. Në këtë rast, pensioni suplementar i pleqërisë është sa 50% e pensionit të pleqërisë, pra 13,000 lekë / muaj. Pra, ish ushtaraku do të përfitojë pension suplementar pleqërie në masën 13,000 lekë lekë/muaj.

PËRFITUESIT

Edhe ushtarakët që kanë

punuar në një prej institucioneve të përcaktuara me ligj kanë të drejtën e përfitimit të pensionit suplementar. Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore, përfitim suplementar kanë të drejtë të marrin të gjithë Ushtarakët e Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë; punonjësit e Policisë së Shtetit; ata të Gardës së Republikës, punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit si dhe ata të Policisë së Burgjeve. Gjithashtu, nga pensioni suplementar mund të përfitojnë edhe punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, ata të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm si dhe punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes. Sipas ligjit, ka disa lloj përfitimesh që administrohen nga ISSH-ja, e respektivisht bëhet fjalë për: pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi; pensionin suplementar të pleqërisë; pensionin suplementar të invaliditetit; si dhe për atë familjar. Kështu për të përfituar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, burrat duhet të kenë mbushur moshën 47 vjeç e të kenë jo më pak se 15 vite pune, ndërsa gratë duhet të jenë mbi 42 vjeç e të kenë jo më pak se 12 vite shërbimi. Ndërkohë mund të përfitojnë pension suplementar pleqërie të gjitha kategoritë e sipërpërmendura, dhe pensioni suplementar i invaliditetit po këto kategori që janë deklaruar invalidë dhe përfitojnë pension i invaliditetit të plotë apo të pjesshëm, sipas Ligjit nr. 4171, "Për sigurimet shoqërore të RPSH" dhe Ligjit nr. 7703, "Për sigurimet shoqërore në RSH". Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije se kur personat e familjes në ngarkim të personave të sipërpërmendur dhe familjet e ushtarakëve që humbasin jetën në krye të detyrës e përfitojnë pension familjar, sipas Ligjit kanë gjithashtu të drejtën e marrjes së pensionit suplementar familjar.

PRESS RELEASE

Tirana on, 20.08.2018

"Raiffeisen Vizion": the newest fund from Raiffeisen Invest, one more alternative of investments in Lekë

Raiffeisen Invest sh.a (RIAL), a company licensed from the Financial Supervisory Authority (FSA) for the Management of Investment Funds and Voluntary Pension Funds, presents the newest investment fund, Raiffeisen Vizion fund.

Raiffeisen Invest sh.a is the company that built the fundamentals of investment funds in Albania and developed it thanks to cooperation and support from FSA. Following the success of the Prestige fund and the Raiffeisen Invest Euro fund, RIAL offers to the Albanian investors another investment opportunity in Leke, aiming to diversify the financial port-

folio through longer-term investments.

The objective of the Raiffeisen Vizion Fund is to maximize total short-term returns to investors, aiming to maintain their capital and provide sufficient liquidity.

This fund is suitable for all investors, whether physical or legal persons, who have low liquidity needs and long-term investment horizons, prepared to take on the risks listed in the fund's prospect against the potential for a satisfactory return on investment.

All interested investors can go to the branches of Raiffeisen Bank to invest in the new fund. The minimum amount of initial investment in the Fund is 30,000 Lekë. This amount can be increased to a value of at least 10,000 Lekë.

"The creation of the Raiffeisen Vizion Fund shows our ongoing commitment to provide the Albanian public with a wide range of investment products outside the spectrum of banking products, in line with their risk profile. This is the third investment fund under the management of Raiffeisen Invest, created in

parallel with the increase of awareness and knowledge on investment funds in Albania. As leader in the market, we will continue to manage investor assets with professionalism, integrity and transparency by implementing best asset management practices and contributing to the sophistication of the market as a whole. In a low interest rate environment, Raiffeisen Vizion will be a very good investment option," said Edlira Konini, Executive Director of Raiffeisen Invest sh.a.

The Raiffeisen Vizion Fund was approved by Fi-

nancial Supervisory Authority with decision number 143 date 30 July, 2018. This is an open public fund, which will be offered / distributed via Raiffeisen Bank branch network starting from August 20th, 2018.

The Raiffeisen Vizion Fund will invest mainly in Albanian Government Securities.

Raiffeisen Bank Albania owns 100% of Raiffeisen Invest sh.a shares, which will continue to manage Private Pension Funds in addition to Raiffeisen Invest Euro and Raiffeisen Prestige Fund.

Voltiza Duro

Ja kategoritë që mund të fitojnë bursa merite dhe nevoje në universitetet e SHBA-së

Studime në Amerikë, 5 hapat që duhet të ndiqni për t'u pranuar

Ambasada: Kriteret, si do të vlerësohet aplikimi

Të gjithë ata që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në një prej universiteteve amerikane, tashmë mund të njihen me kriteret e pranimit. Ambasada Amerikane në Tiranë ka bërë me dije se kandidatët mund të drejtohen në Qendrën Informativë të Arsimit Amerikan në Shqipëri për t'u konsultuar me ekspertët e arsimit të lartë. "Je një student i interesuar për të ndjekur një universitet apo kolegji në Shtetet e Bashkuara? Ndiqni bashkëbisedimin e EducationUSA mbi "Procesin e Pranimit të Shtetave të Bashkuara". Ekspertët të arsimit të lartë, studentët ndërkombëtarë dhe Departamenti i Shtetit diskutuan se si funksionon procesi i pranimit në arsimin e lartë të Shteteve të Bashkuara. Mësoni mbi kriteret dhe se si do të vlerësohet aplikimi juaj", theksohet në njoftimin e ambasadës.

APLIKIMI DHE KRITERET

Në Amerikë, universitetet janë më të pavarura për sa i përket kriterëve të pranimit që vendosin dhe datës së aplikimit. Kjo do të thotë që secili universitet në Amerikë ka kriteret e veta të pranimit dhe afatet e veta të aplikimit. Të gjithë që përbushin këto kriteret të aplikimit mund të aplikojnë në universitete. Instrukturët e Education USA i orientojnë dhe qartësojnë ap-



likantët, që të ndjekin në mënyrë vijuese hapat e duhur. Kandidatët mund të aplikojnë për të gjitha degët, madje edhe degë që në Shqipëri ende nuk ka. Drejtësia dhe Mjekësia janë dy nga degët që kanë një

rrugëtim ndryshe nga Shqipëria. Shumë universitete lejojnë edhe studimin e dy degëve njëkohësisht, në mënyrë që studentit të jetë më i kompletuar për tregun e punës. Për sa i përket kriter-

5 HAPAT E APLIKIMIT PËR STUDIME NË SHBA:

- ◆ Shqyrto alternativën më të mirë për arsimim;
- ◆ Përfundo dokumentacionin për aplikim;
- ◆ Financo studimet, duke aplikuar për bursë;
- ◆ Apliko për vizë studentit;
- ◆ Përgatit udhëtimin për në USA.

PROGRAMET E STUDIMIT

Kandidatët mund të aplikojnë për të gjitha degët, madje edhe degë që në Shqipëri ende nuk ka. Drejtësia dhe Mjekësia janë dy nga degët që kanë një rrugëtim ndryshe nga Shqipëria. Shumë universitete lejojnë edhe studimin e dy degëve njëkohësisht, në mënyrë që studentit të jetë më i kompletuar për tregun e punës.

BURSAT

Një pjesë e financimit mund të jetë edhe ndërmjet bursave. Bursat ndahen në bursa merite dhe bursa nevoje. Bursa e meritës i akordohet studentëve të shkëlqyer të shkëlqyer si në rezultatet e gjimnazit edhe në provimet e TOEFL dhe SAT. Ka universitete që ofrojnë bursa nevoje për studentët ndërkombëtarë.


eve të pranimit, është në varësi të universitetit, por vlen të theksohet se moshë nuk është kriter. Megjithatë në vija të përgjithshme janë: formulari i aplikimit, tarifa e aplikimit (nëse ka), provimet e TOEFL dhe SAT, letra rekomandimi, eseja, aktivitetet jashtëshkollore, vërtetimi bankar, etj. Provimi i TOEFL është provimi që mat nivelin e gjuhës angleze, ndërsa SAT janë provim mbi matematikën dhe gjuhën angleze.

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR

Education USA e ka thjeshtuar gjithë procesin duke e përbledhur në pesë hapa. Hapi i parë është gjetja e universitetit. Në Amerikë ka mbi 4,500 institucione të arsimit të

lartë, që ndahen në kolegje 2 vjeçare, universitete dhe kolegje 4 vjeçare. Hapi i dytë është financimi i studimeve. Studentët shqiptarë mund të aplikojnë për bursa të plotë dhe bursa të pjesshme. Hapi i tretë është procesi i aplikimit. Në momentin që dokumentet janë gati, kandidatët mund të bëjnë aplikimin me postë ose elektronik në varësi të kërkesës së universitetit. Hapi i katërt është aplikimi për vizë. Në momentin, që vjen dokumenti i pranimit nga universiteti mund të aplikohet për vizën studentore F1. Hapi i pestë është takimi para nisjes në Amerikë. Ndërkohë nuk ka një numër të aktuar të studentëve që pranoen brenda një viti, madje numri i stu-

dentëve shqiptarë që aktualisht studiojnë në Amerikë është në rritje. Zakonisht tarifa totale e studimit përbëhet nga taksa e shkollës dhe nga shpenzimet e jetesës. Një pjesë e financimit mund të jetë edhe ndërmjet bursave. Bursat ndahen në bursa merite dhe bursa nevoje. Bursa e meritës i akordohet studentëve të shkëlqyer si në rezultatet e gjimnazit edhe në provimet e TOEFL dhe SAT. Gjithashtu, çdo dokument i dorës së aplikimit do të vlerësohet për të arritur në vendimin nëse e meriton bursën e meritës. Ka, gjithashtu, universitete që ofrojnë bursa nevoje për studentët ndërkombëtarë. Në momentin që studentit që është pranuar tregon që nuk ka mundësi të paguaj universitetin, atëherë universiteti mund t'i akordojë një bursë nevoje.



Attesis per Punte / Skills for Jobs

VACANCY ANNOUNCEMENT: National Project Specialist- Labour Market Insertion

Swisscontact (SC) is a Swiss-based international foundation specialized in Vocational Education and Training and Private Sector Development. It is active since 1994 in Albania implementing various projects. SC stands for innovative approaches, cooperation with the private sector, a strong focus on practical learning, orientation towards the world of work, decentralization with local stakeholder involvement, and contributions towards systems reform. Skills for Jobs (S4J) is a project of the Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) implemented by Swisscontact. The project commenced in October 2015 (Inception Phase 10/2015-4/2016) and will run until February 2019 (First Phase 05/2016-02/2019).

Recently, a vacancy for a **Labour Market Insertion Specialist** has arisen at Skills for Jobs Project, under Labour Market Insertion Component.

JOB ROLE:
The **Labour Market Insertion Specialist** works closely with the Component Manager LMI and other staff members and (short-term) experts to ensure smooth development and implementation of Component's activities. The expert will be focused in supporting and developing activities related to labour market insertion for S4J project's beneficiaries. The person, should build also on previous initiatives S4J undertook and design a model for non formal provision. She/ he should build long term and market oriented solutions with and in benefit of private sector and VET Providers.

RESPONSIBILITIES:

- Responsible for contributions the content-related activities in the LMI component, importantly related to career guidance and job mediation
- Evaluate existing and new short courses content and training methods with an eye toward continuous improvement and learning effectiveness by identifying companies skills needs in the market and translate them to market driven trainings, contributing to the Training of Teachers/ Instructors regarding labour market insertion, networking with current and new Training Service Providers to foster and build relationships through existing and new service providers base and take the opportunity to make face to face presentations to improve and increase Non formal offer.
- Support of (short- and mid-term) experts assigned to LMI;
- Organize and co-ordinate the development and implementation of activities in the component in accordance with the work plan;
- Contribute to reporting ; direct reporting line to Labour Market Insertion Component Manager
- Contribute to the preparation of reports and work plans (i.e.: monthly, quarterly);
- Contributes to knowledge management and capitalization of experiences;

REQUIREMENTS:

- At least 5 years' experience working in the development sector and /or private sector with respect to Human resources and/ or Skills Development
- University degree, preferable in HR management studies, Humanities and/or related fields
- Knowledge of the practices of employment promotion and non formal training is highly preferred;
- Excellent interpersonal skills to contribute to the positive reputation of the organisation;
- Excellent analytical and strategic skills;
- Experience in project cycle management; Experience in project planning and reporting;
- Strong communication and networking skills
- Fluency in English (speaking, reading and writing); strong communication and networking skills
- Excellent Computer literacy in MS Office (especially Excel) and Internet applications.

Location: Place of work in Tirana. Frequent travelling in Vlora, Berat, Lezha and Shkodra

Starting Date: Tentative by 17 September, 2018


Assignment End Date: 28th Feb, 2019 (with extension possibility)

Application Documents: Curriculum Vitae and Motivation letter (max 1 page) or Video Presentation (max 3 Min)


Deadline for Application: Aug 31, 2018

Application sent to: al.info@swisscontact.org

For further information, please refer to our websites:
<https://www.swisscontact.org/en/country/albania/our-office/jobs.html>
<https://www.swisscontact.org/en/country/albania/our-office/jobs.html>



Swisscontact • Eastern Europe Office • Rr. Skenderbej • Villa 49 • Tirana, Albania • Tel/Fax: +355 (0)42 232 778 • www.swisscontact.org



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi catering në ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 7.800.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Haliili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një bankë tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi catering në ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 11 Shtator 2018, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

RREFIMI

Pamela Aliaj

Rrëfihet stërmbesa e Skënderbeut, Sophie: Ja historia e prejardhjes sime shqiptare

"Unë jam një nga pasardhëset e linjës së gjakut të atij njeriu të madh"

Shumë është folur lart e poshtë për pasardhësit si dhe trashëgimtarët e heronjve të historisë sonë. Por po të kthehemi shekuj më parë, në epokën otomane, do të kujtohem me siguri për heroin tonë kombëtar: Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Historia që ai la pas dhe luftërat që bëri për të mbajtur të bashkuar ndaj pushtuesve atë që sot ne mund ta quajmë vendin tonë, janë të shumta. Mund të themi pa frikë se legjenda e tij ka marrë dhenë, por pas vdekjes së tij çfarë ndodhi? Ku 'u zhduk' familja e tij? Ku ndodhen sot ose më saktë: A ka pasardhës apo trashëgimtarë të linjës së gjakut të Skënderbeut? Shumë studime janë bërë dhe në 'heshtje' ata që mund të quhen pasardhësit të gjakut të tij, janë shpërndarë në cepat e botës (ose nuk jetojnë më). Ndërkohë që para pak kohësh, ajo që më bëri përshypje ishte një vajzë e re, Sophie, e cila kishte një mbiemër tepër interesant, dhe më tepër, thoshte se ishte stërmbesa e Gjergj Kastrioti Skënderbeut, heroit tonë kombëtar. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Sophie na ka rrëfyer të vërtetën e prejardhjes së saj dhe familjes. Gjithashtu, ajo ka folur edhe për studimet e bëra nga ekspertë dhe ambasada për të lëviztur prejardhjen e linjës së saj të gjakut. Të jetë një Skënderbeu? Për më tepër ndiqni historinë ekskluzive në intervistën e mëposhtme.



rritur në Australi, dhe po, kam qenë në Shqipëri disa herë.

A keni ndonjë të afërm këtu në Shqipëri?

Kam shumë shokë aty dhe jam e sigurtë që kam edhe të familjarë të largët që jetojnë aty të cilët nuk i njoh.

Ju thonë se jeni stërmbesa e gjeneratës së 15-të të heroit tonë, Gjergj Kastrioti nga Kruja. Si jeni kaq e sigurtë lidhur me këtë gjë? A keni ndonjë dokument që mund ta vërtetojë atë që ju thonë?

Po, unë jam pa diskutim një pasardhëse e linjës së gjakut (14 gjenerata) të Gjergj Kastri-

oti Skënderbeu, por jo trashëgimtarja e tij, siç kanë thënë disa. Linja e gjakut është e nënës dhe vjen nga gjenerata e 6 e stër-stër-gjyshes sime, Princeshës Giuseppa Castriota Scanderbeg, e cila u martua me Marquis Vincenzo Bernardini. Ne jemi pasardhës të linjës së Pardos, siç është edhe familja e Kastriot Skënderbeut në Leçe të Italisë; nga i njëjti vend që ka prejardhjen dhe familja e nënës sime. Historia e një princeshe në familje ishte një legjendë e vjetër familjare deri sa stër-daja im nisi kërkimet dhe krijoi pemën familjare. Pema është rikërkuar, ashtu siç duhet vite më parë dhe kjo ndodhi kur ne kuptuam se kush ishte princesha-një nga stër-stërmbesat e linjës së gjakut të Skënderbegëve. Pema e familjes sonë është kontrolluar edhe nga ambasadat dhe tjerë dhe kanë arritur në përfundim se unë jam një nga pasardhëset e linjës së gjakut të atij njeriu të madh.

A keni ndonjë të afërm në Shqipëri që është nga familja Kastrioti?

Jo me aq sa kam unë ditëni, por testi i ADN-së ka treguar se unë kam gjak si shqiptari dhe arbëreshi. Kjo nënkupton që duhet të kem njëzë me të cilët kam lidhje familjare në Shqipëri, jam e sigurtë.

Çfarë hobi keni ju Sophie? Çfarë të pëlqen të bësh më tepër në jetë?

Muzika është hobi dhe pa-

sioni ashtu si dhe profesioni im. Unë, gjithashtu, pëlqej fotografimin dhe dua kafshët, artin dhe natyrën. Unë jam një person shumë i thellë spiritiu- al.

Mendoj se ju e njihni shumë mirë historinë e Gjergj Kastrioti. Për sa dekada familja juaj ka qenë aty? Përse nuk u kthyet sërish në Krujë?

Po unë e njoh historinë e atij burri të madh me një edukim të lartë dhe shumë trim. Ai është heroit im. Jam shumë krenare për të dhe për gjakun që unë mbaj që vjen nga ai. Paraardhësit e mi shqiptarë lanë Shqipërinë kur perandoria Osmane i pushtoi pas vdekjes së Skënderbeut. Ata u vendosën në jug të Italisë, në Leçe/ Apulia. Gjysha ime italiane u largua nga Italia para shumë vitesh, jetoi në Francë dhe më vonë në Angli. Ajo së bashku me prindërit e mi lanë



Mbretërinë e Bashkuar në fillim të '90 për të jetuar më vonë në Australi ku dhe unë linda.

A keni ndonjë armaturë të vjetër apo diçka tjetër që keni trashëguar nga Gjergj Kastrioti?

Jo, do të doja të kisha. Do të ishte një mrekulli nëse do të kishte mbijetuar ndonjë gjë pas gjithë këtyre shekujve. Gjithçka që ka mbetur, ruhet në muzeume, siç është helmata dhe shpata e tij.

Më flisni më tepër për veten Sophie. A do të dëshironit të ishit një modele? A keni marrë ndonjë propozim interesant?

Nuk e kam menduar veten asnjëherë si modele, por do të dëshiroja të isha një aktore. Unë kam qenë në televizion,


nëpër reklama kur kam qenë fëmijë. Ndërkohë që tani jam gati të nxjerr këngën time të parë dhe videon. Unë jo vetëm jam pjesë e saj, por jam krenare të them se kam qenë e përfshirë edhe në drejtimin dhe editimin e saj, gjithashtu.

A keni ndonjë person të veçantë në jetën tuaj? A do të dëshironit të martoheshit me një djalë shqiptar?

Të jem e sinqertë, unë nuk kam kohë për romancë në jetën time duke qenë se jam shumë e zënë. Nëse unë gjëj personin e duhur dhe ai është shqiptar, pse jo. Nuk jam duke kërkuar për momentin duke qenë se jam e zënë me gjëra të tjera në jetën time.

A ka ruajtur familja juaj traditat të vjetra të paraardhësve tuaj? Mund të më përmendi ndonjë që edhe jua kanë mësuar juve?

Stër-gjyshi im i ka folur për traditat arbëreshe gjyshes sime kur ka qenë e vogël por për fat të keq ato janë harruar tani. Mund të them se familja ime dhe unë kemi qenë gjithnjë të tërhequr nga muzika shqiptare. Gjithnjë më ka tërhequr që ta luaj atë muzikë, kështu që, kur zbulova rrënjët e mia shqiptare, gjithçka kishte kuptim. Unë i dua traditat e mia shqiptare.



"Mercenarët e agjentët të përdoren nën pretextin e familjarëve të anëtarëve të MEK"

Këshilli i Rezistencës iraniane: Dërgohen spiunë në Shqipëri dhe Europë

Përgatiten për terrorizëm, Irani u bën presion qeverive europiane



oriteti është të vihen në punë punonjësit dhe mercenarët e regjimit, sidomos agjentët jo-iranianë të cilët mund ta kryejnë misionin e tyre nën maskën e gazetarisë.

4. Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Inteligjencës, dhe Forcat Quds janë urdhëruar t'i bëjnë presion qeverive europiane, sidomos Shqipërisë, që t'i pakësojnë veprimtaritë e Rezistencës Iraniane. Kjo detyrë duhet të kryhet përmes "qeverive dhe partive" miqësore në rajon, Europë dhe Ballkan, duke përdorur lidhjet politike dhe ekonomike.

5. Mercenarët dhe agjentët e regjimit duhet të dërgohen në Shqipëri dhe të përdoren nën pretextin e familjarëve të anëtarëve të MEK. Ministria e Inteligjencës dhe Forca Quds janë urdhëruar të dërgojnë agjentët e tyre, me ndihmën e disa të ashtu-quajturave organizata jo-qeveritare, në grupe nën pretextin e "Familjarëve të Muxhahedinëve", me të njëjtin model si në veprimet e tyre në Ashraf dhe Liberty.

Këshilli Kombëtar i Rezistencës së Iranit - Komiteti i Sigurisë dhe Antiterrorizmit 16 gusht, 2018

Këshilli Kombëtar i Rezistencës së Iranit që është kundër regjimit thotë përmes një deklarate se Këshilli Suprem i Sigurisë për Spiunazh në Iran ka dhënë urdhra të reja për përgatitjen e terrenit për terrorizëm kundër rezistencës iraniane në Europë dhe Shqipëri. Këshilli Kombëtar i Rezistencës së Iranit thotë se stacionet e Ministrisë së Inteligjencës janë urdhëruar të mbledhin informacione dhe t'i bëjnë presion qeverive europiane, sidomos Shqipërisë, që t'i pakësojnë veprimtaritë e Rezistencës iraniane. "Mercenarët dhe agjentët e regjimit duhet të dërgohen në Shqipëri dhe të përdoren nën pretextin e familjarëve të anëtarëve të MEK" - thotë Këshilli i Rezistencës së Iranit.

DEKLARATA E PLOTË:

Urdhra të Rinj nga Këshilli Suprem i Sigurisë për Spiunazh dhe për Përgatitjen e Terrenit për Terrorizëm Kundër Rezistencës Iraniane në Evropë dhe Shqipëri. Duke iu referuar protestave të përhapura në qytete të ndryshme në gusht, Hassan Rouhani, Presidenti i regjimit klerikal, tregoi armiqësinë e tij ndaj PMOI-MEK dhe tha më 6 gusht: "Nuk ka asgjë të keqe në protestat e popullit...por nuk duhet të jenë përgjigjja e disa njerëzve ndaj (kërkesave të) një grupi." Më pas, Këshilli Suprem i Sigurisë së regjimit, në një udhëzim drejtuar Ministrisë së Inteligjencës, Forcave terroriste Quds, Inteligjencës së Gardës Revolucionare dhe agjencive të tjera të përfshira në ekspor-

tin e terrorizmit dhe fondamentalizmit, i urdhëroi të marrin masa të mëtejshme për të spiunuar MEK-në dhe Rezistencën Iraniane dhe për t'u hapur rrugën akteve terroriste.

1. Stacionet e Ministrisë së Inteligjencës në vende të ndryshme europiane janë urdhëruar të mbledhin shumë informacion nga lëvizjet dhe veprimtaritë dhe të përdorin më shumë burime.

2. Ministria e Inteligjencës dhe Forcat Quds duhet të ekzaminojnë af-

tësitë dhe potencialet njerëzore, politike dhe teknike për akte terroriste në vendet europiane, veçanërisht në Shqipëri, përmes përdorimit të mercenarëve jo-iranianë, në mënyrë të tillë që këto veprime të mund t'i atribuohen "konflikteve të brendshme të Muxhahedinëve (MEK)" apo "incidenteve natyrore" dhe regjimi të mos dalë fajtor.

3. Për të justifikuar komplotet dhe skandalet terroriste të zbuluara tashmë në Shqipëri dhe Francë (prill dhe korrik 2018), është

e domosdoshme të shtohen dimensionet e luftës psikologjike dhe fushatës denigruese të shoqëruara nga influksi masiv i informacionit të rremë dhe prodhimi i dokumentarëve të rremë. Në këtë aspekt, Ministria e Inteligjencës dhe agjentët e mercenarët e saj jashtë vendit duhet të bashkëpunojnë me këshilltarët kulturorë të regjimit në vendet europiane, drejtorinë jashtë vendit të Radios dhe Televizionit Shtetëror, Organizatën e Propagandës Islamike dhe me organizata të tjera përkatëse. Pri-

Vladimir Putin rikthehet në Berlin pas 4 vitesh tensione

Shefi i Kremlinit takon Merkelin, ja çfarë u diskutua në mbledhjen që zgjati 3 orë



Krizat në Siri, Ukrainë dhe gazsjellësi Nordstream 2 ishin në fokusin e takimit mes Kancelares gjermane Angela Merkel dhe Presidentit rus Vladimir Putin. Shefi i Kremlinit mbërriti mbremjen e së shtunës në Berlin, në takim të parë zyrtar pas 4 vitesh me Merkelin në kryeqytetin gjerman, që pas krisjes në marrëdhëniet mes dy vendeve pas aneksimit të Krimesë nga Rusia. Për Kancelaren gjermane Angela Merkel nevojitet dialog për të futur sa më shpejt krizën siriane në rrugën e zgjidhjes, për t'u dhënë

fund vuajtjeve të luftës 7-vjeçare të popullit sirian. Por Putin tha se Rusia ka bërë të pamundurën për t'i dhënë fund konfliktit me operacionet ushtarake për grupet ekstremiste radikale, duke i hapur rrugë operacioneve humanitare në terren. Valën e madhe të emigrantëve që shkaktoi kjo krizë, Putin e quajti si tepër të rëndë për Europën. Kjo valë shkaktoi fuqizimin e radikalëve të djathtë në Gjermani dhe gjithë Europën, çka detyroi Merkelin të heqë dorë nga politika e dyerve të hapura për ta. Për krizën e Ukrainës, dy liderët

ranë dakord që së shpejti të krijohet një mision paqeruajtës i Kombeve të Bashkuara në rajonet lindore ku separatistët filo-rusë luftojnë me armë me forcat e Kievit. Ndërsa për gazsjellësin Nordstream 2, që përcjoll gazin rus përmes detit Balltik në Gjermani, dy liderët ishin të njëjtit mendim, se projekti është krejtësisht ekonomik dhe aspak politik. Presidenti amerikan Donald Trump kritikoi ashpër projektin pasi tubacioni rrit varësinë energjetike të Gjermanisë nga Rusia, kundërshtari numër 1 i NATO-s.

SHKURT

Tërmeti i fuqishëm me magnitudë 8.2

Një tërmet i fuqishëm me magnitudë 8.2 ka goditur Oqeanin Paqësor pranë Fijit dhe Tonga këtë të diel, fatmirësisht pa shkakuar të lënduar: Qendra Paralajmëruese e Tsunamëve të SHBA, gjithashtu, tha se tërmeti ishte shumë i thellë për të shkaktuar një cunami. Tërmeti ishte 357.7 milje (560 km) nën tokë. "Unë nuk besoj se tërmete të tilla mund të shkaktojnë dëme. Njerëzit e ndiejnë, por është kaq i thellë sa që nuk do të prisja ndonjë dëm", tha geologjia amerikane Jana Pursley. Tërmeti u raportua fillimisht me magnitudë 8.0 dhe pastaj me 8.2, mjaftueshëm i fortë për të shkaktuar dëme të jashtëzakonshme po të mos ishte aq e thellë. Epiqendra ishte 167 milje (270 km) në lindje të Levukës në Fijit dhe 275 milje (443 km) në perëndim të Neiafu në Tonga.

Sulmi në Angli, një i akuzuar për vrasje në tentativë

Në Angli një burrë është akuzuar për vrasje në tentativë pasi përplasi me makinë kalimtarët jashtë parlamentit. Salih Khater 29 vjeç, nga Birmingham, thuhet se përplasi me makinë qytetarët me biçikleta dhe këmbësorët më 14 gusht. Rasti është duke u trajtuar si terrorizëm, shtoi një zëdhënës i policisë. Sipas BBC, ai do të lihet në paraburgim nga Gjakatën e Westminster të hënën. Tre persona mbetën të plagosur në incidentin, i cili po trajtohet nga prokurorët si terrorizëm për shkak të vendndodhjes, metodologjisë dhe faktit që shënjestër e sulmit ishin oficerë të policisë dhe civilë. Khater, një shtetas i Britanisë së Madhe me origjinë nga Sudani, akuzohet për vrasje në tentativë jashtë Parlamentit dhe për tentativë për të vrarë policët.

6 muaj burg për këshilltarin elektoral të Donald Trump

Robert Myler, prokurori në posaçëm i çështjes Rashagejt, ka kërkuar dënimin me 6 muaj burg të ish-këshilltarit elektoral të Donald Trump, George Papadopoulos. Sipas mediave amerikane, në kërkesën e Myler argumentohet se Papadopoulos ka pranuar se ka gënjyer në lidhje me kontaktet e tij me rusët teksa ishte pjesë e stafit elektoral të Trump. Dhe pikërisht mashtrimi që ai ka bërë përpara agjentëve të FBI-së ka qenë bosh në kërkesës së Myler. Mes kontaktëve të Papadopoulos rezultat edhe një profesor nga Londra që dy vjet më parë tha se Rusia kishte material kompromentues ndaj kandidatës demokratike Hillary Clinton.



MJEKU POPULLOR



Si të kuroni
artritin me bimë
medicinale

KESHILLA



Efektet e
mrekullueshme të
kafes së zezë
në organizëm

Entela Basha:



◆ Mjekja neurologe:
Sëmundja e
alzheimerit, burimi
kryesor i vdekjeve
te të moshuarit

Si të trajtoni sindromin e demencës, medikamentet specifike

"Kujdes, shkakton rënie
të funksioneve të trurit"

10 këshilla për të eliminuar stresin nga jeta juaj

Mjekja neurologe: Sëmundja e Alzheimerit, burimi kryesor i vdekjeve të moshuarit

Entela Basha: Si të trajtoni sindromin e demencës, medikamentet specifike

"Kujdes, shkakton rënie të funksioneve të trurit"

Voltiza Duro

Me kalimin e moshës, mund të prekemi nga një rënie progresive e funksioneve të larta të trurit, e cila njihet si sindromi i demencës. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në Gazeta Shqiptare, mjekja neurologe, Entela Basha tregon se ky sindrom mund të prekë një ose më shumë fusha të konjcionit, si të mësuarit, kujtesën, gjuhën, funksionet ekzekutive dhe vëmendjen. Më tej neurologjia thotë se shkak kryesor I zhvillimit të demencës është sëmundja e Alzheimerit që shërben edhe si një nga burimet kryesore të morbiditetit dhe mortalitetit në popullatën e moshuar.

Cfarë është sindroma e demencës dhe cilat janë pasojat që shkakton në organizmin e njeriut?

Demencia është një sindrom që karakterizohet nga një rënie progresive e funksioneve të larta të trurit në një ose më shumë fusha të konjcionit, siç janë: të mësuarit, kujtesa, gjuha, funksionet ekzekutive dhe vëmendja, duke cenuar pavarësinë funksionale të individit.

Cilat janë shkaqet kryesore që ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm të sindromës dhe cilat kategori janë më të predispozura për t'u prekur?

Sëmundja e Alzheimerit është shkak më i shpeshtë i demencës dhe një nga burimet kryesore të morbiditetit dhe mortalitetit në popullatën e moshuar.

Në të gjithë botën numërohen 47 milionë njerëz të prekur nga demencia. Prevalenca sipas moshës shkon në 5-7%. Me rritjen e jetëgjatësisë po shohet ndjeshëm numri i pacientëve me demencë. Që të dyshosh sindromin demencial duhet evidentuar nga të dhënat klinike çrregullimi i konjcionit, në të paktën një nga fushat e mëposhtme: të mësuarit dhe kujtesa, gjuha, funksionet ekzekutive, vëmendja, funksionet motor dhe perceptuese. Humbja e funksionit vlerësohet duke u krahasuar me gjendjen paraardhëse të individit dhe deficitet konjitive duhet të ndikojnë në jetën e përditshme të tij.

Si mund të dallohet që një person është i prekur nga demencia, dhe jo nga humbja e kujtesës?

Demencia duhet dalluar nga simptomat e humbjes së kujtesës apo çrregullime të sjelljes dhe të personalitetit, të cilat janë joprogresive ose të nxitura nga një sëmundje sistematike, medika-

mentë.

Cilat janë disa prej formave të çrregullimeve të trurit që përfshijn sindromin i demencës?

Sindromi demencial përfshijn: Sëmundja e Alzheimer-it (AD), Demencia me Leëy bodies(DLB), Demencia fronto-temporale(FTD), Demencia vaskulare(VaD), Sëmundja e Parkinsonit me demencë(PDD). Ka dhe disa forma më të rralla si: paraliza supranukleare progresive, sëmundja e Huntingtonit, demencia e lidhur me abuzimin nga alkooli etj. Pjesa më e madhe e pacientëve nuk paraqiten në spital për çrregullime të kujtesës, ndërkohë janë familjarët e tyre që detyrohen t'i sjellin për vlerësim si rrjedhojë e çrregullimeve të kujtesës.

Cfarë vështirësish shfaqin pacientët?

Pacientët me demencë kanë vështirësi në: marrjen dhe përpunimin e informacioneve të reja (vështirësi në kujtimin e ngjarjeve); kryerjen e veprimeve të vështira (balancimin e objekteve); llogjika (vështirësi socializimi me të panjohur; çrregullime të orientimit (harrojnë vendndodhje dhe ambiente të njohura); gjuha (vështirësi në gjetjen e fjalëve); si dhe në sjellje.

Si mund të dallohet që një person është i prekur nga demencia, dhe jo nga humbja e kujtesës?

Demencia duhet dalluar nga simptomat e humbjes së kujtesës apo çrregullime të sjelljes dhe të personalitetit, të cilat janë joprogresive ose të nxitura nga një sëmundje sistematike, medika-



Entela Basha

mente, çrregullime psikiatrike, apo patologji organike të trurit. Çrregullimet konjitive të lehta karakterizohen nga çrregullime të kujtesës, por që nuk ndikojnë në funksionimin normal. Këta subjekte kanë risk më të lartë të shfaqin demencë me kalimin e viteve.

Si bëhet diagnostikimi i saktë i demencës?

Vlerësimi i pacientëve me çrregullime të kujtesës, që mund të jetë një shenjë paralajmëruese për shfaqjen e demencës, nuk mund të bëhet në një seancë vlerësuese

të vetme. Vlerësimi në dinamikë merr rëndësi shumë të madhe, ku krahasimi i testeve të vlerësimit të konjcionit të çon drejt diagnozës. Mjaft e rëndësishme është marrja e historisë me kujdes, vlerësimi i medikamenteve të përdorura që ndërhyjnë në funksionet superiore, ekzaminimi objektiv dhe neurologjik, vlerësimet laboratorike dhe imazherike, janë kriteret që përjashtojnë shkaqet e mundshme të demencave ose konfirmojnë diagnozën. Në çdo formë të demencës, duhet vlerësuar konjicioni me teste specifike. Testi më i hershëm dhe më i shpeshtë është MMSE(mini mental state examination). Testi është i realizueshëm për 7-10 min dhe me anë të tij vlerësohet: orientimi, përfshirja, vëmendja, përllogaritjet matematikore, çrregullimet gjuhësore. Vlerësimi maksimal është 30 pikë dhe cut-off është vendosur 24 pikë, që nënkupton se nën 24 pikë pacienti ka risk për të shfaqur demencë. Vlerësimi përshtatet me nivelin arsimor dhe social të subjektit në ekzaminim. Vlerësimi imzherik me anë të rezonancës magnetike është i domosdoshëm pasi eviden-

ton atrofinë fokale ose të gjeneralizuar, si dhe lezionet e substancës së bardhë.

Cilat janë disa prej metodave që ndihmojnë në trajtimin e sëmundjes?

Trajtimi kryesor i sëmundjes konsiston në menaxhimin e simptomave, trajtimin e çrregullimeve të sjelljes, mirëfunksionimin e pacientëve në ambientin rrethues. E ardhmja e trajtimit konsiston në gjetjen e medikamenteve specifike dhe modifikuese të sëmundjes, jo vetëm për parandalimin e progresit të saj. Inhibitorët e cholinesterazës (donepezil, rivastigmine, galantamine) janë grupi kryesor i medikamenteve që përdoren në pacientët me Alzheimer, të cilët kanë një reduktim të sasisë së choline acetil transferazës. Pakësimi i sintezës së acetilkolinës dëmtion funksionin cholinergjik kortikal. Ky grup medikamentesh rrit transmetimin kolinergjik, duke përfutur benefite simptomatike modeste në pacientët me demencë. Mësimi është një medikament i grupit të antagonistëve të receptorëve NMDA. Mekanizmi i veprimit është krejt i ndryshëm nga grupi i inhibitorëve të cholinesterazës. Ai mendohet të jetë neuroprotektiv. Glutamati është një neurotransmetues eksitator principal në korteks dhe neuronet hipokampale, që janë të përfshira në të mësuarit dhe kujtesën.

Antioksidantët si Vitamina E dhe Selegilina janë studiuar për përfitimet antioksidante në sëmundjen e Alzheimerit. Doza prej 2000 UI/ditë mund të ketë një benefit modest në progresionin e sëmundjes, ndërkohë që ende nuk ka të dhëna të mira e të mjaftueshme për përdorimin e selegilines edhe për shkak të efikasitetit dhe kostos, si edhe të efektive anësore të saj. Trajtimet jomedikamentoze konsistojnë në trajtime rehabilituese, okupacionale dhe parandalimi e faktorëve të riskut, ku përfshihen identifikimi dhe trajtimi i faktorëve të riskut të strotkut, sëmundjeve kardiovaskulare, parandalimi i përdorimit të alkoolit, i cili ekzacerbon disfunksionet konjitive dhe çrregullimet e sjelljes në pacientë me demencë.



Në 2013 u përcaktuan kriteret për vlerësimin DSM V për vlerësimin e de-



Voltiza Duro

Të gjitha sëmundjet si artriti reumatoid, borsiti, menisqet, problemet e dhimbjeve lumbare, hernia discale, pak a shumë kanë të njëjtën natyrë. Në thelb ato janë veçse një infeksion alergjik që prek membranat sinoviale. Këto membrana janë si qese që mbajnë lëngun sinovial, dhe ky i fundit ndodhet midis kockave dhe kyçeve e nuk i lejon ato që të fërkohen e të konsumojnë njëra-tjetrën. Ky inflamacion alergjik që ndodh në kyçe prek moshën nga më të ndryshmet, duke filluar që nga moshat 20-30 vjeçe. Fillimisht këto baktere qëndrojnë në gjendje pasive, por bëhen aktive në momentin që depozitohen në palcën e kuqe të kockave dhe nëpër kyçe e shkaktojnë dhimbje. Format më të njohura janë disa, ku mund të përmend Shafarad Stiliid, i cili shfaqet në moshat 3-7 vjeçare, si pasojë e një sëmundjeje të shpeshtë në bajame apo veshka. Këto dhimbje bëhen aq të bezdisshme, sa fëmijët mund të arrijnë në atë pikë sa nuk lëvizin dot. Një tjetër formë është artriti kronik, që përparon në mënyrë progresive në trupin e njeriut dhe dhimbja vjen duke u përshkallëzuar. Ndërsa, poliartiriti është një lloj tjetër i artritit, që fillon të lëvizë në pjesë të ndryshme të trupit, pra quhet ndryshe edhe artriti "shëtitës", ku dhimbja në momente të ndryshme, lokalizohet në pjesë të ndryshme. Ka dhe forma të tjera, si gonoartroza, e cila ndodh kur në pjesën e kupave të gjunjëve lëngu sinovial fillon të thahet, dhe këtu depozitohen stafilokokë. Në rastet kur pacienti ka mungesë të theksuar lëngjesh, kjo shpeshherë, shoqërohet edhe me kërcitje të kockave. Një formë tjetër është dhe artriti urik, i cili lidhet drejtpërdrejt me sasinë e lartë të acidit urik në organizëm.

SHKAQET DHE SIMPTOMAT
Në rastet kur tregoheni të pakujdesshëm në kurimin e bajameve, gjëndrat limfatike fillojnë të acarohen dhe prodhojnë limfocitet T, të cilat shumohen në numër dhe trupi prodhon antikorpus kundër faktorit reumatoid që është shumëuar. Këta stafilokokë që zhvendosen nga bajamet, shkojnë në veshka, e më tej hyjnë në qarkullimin e gjakut. Nëse një trup nuk funksionon në mënyrë të sinkronizuar, duke përfshirë këtu gjëndrat endokrine dhe organet e tjera, është më i predispozuar për t'u prekur nga këta ngacmues të jashtëm, ku përfshihen edhe këto baktere që shkaktojnë

Mjeku popullor: Kujdes, inflamacioni mund të fillojë që në moshën 3-vjeçare

Ylli Merja:

Si të kuroni artritit me bimë medicinale

"Efektet çudibërëse të sinapit gjatë trajtimit"



Ylli Merja

sëmundjen e artritit. Me kalimin e kohës fillojnë shqetësimet e para, që shoqërohen me ndjesi këputjeje, lodhjeje, temperaturë, dhimbje gjunjësh e kockash si dhe me mungesë oksigjeni. Këto shenja shfaqen kur stafilokokët hyjnë në gjak e fillojnë të bëhen aktivë, të shumohen dhe të përhapen në trup. Stadi i dytë i kësaj sëmundjeje progresive është që, nëse nuk kurohet, ai përparon në mënyrë të përshkallëzuar. Gjatë këtij momenti kemi përhapje simetrike në të dyja gjymtyrët, dhe fillon të japë dhimbje, dobëson enët e qarkullimit të gjakut dhe i hollon. Këto të fundit, me ndry-

shimin e shtypjes atmosferike bëhen të brishta dhe ulja e shtypjes shkakton çarjen e kapilareve, çka jep shumë dhimbje të pacientit. Një pacient i cili verifikon se ka disa nga simptomat e sipërpërmendura, mund të kryejë disa diagnostikime, si faktori reumatoid, fibrinogjenin, proteinën C reaktive dhe acidin urik. Në momentin që acidi urik rezulton i lartë, atëherë pacienti ka depozitime të larta të kalciumit në kocka, çka shkakton deformimin e kockave, që shfaqet më tepër në gishtat e këmbës dhe të dorës.

KURIMI ME BIMË MJEKËSORE



Duke njohur shumë mirë vetitë kuruese të disa bimëve, ne filluam t'i testonim ato që para 10 vitesh dhe morëm rezultate tepër pozitive. Ne e dimë që artriti dëmton edhe zemrën, kështu që në kompozimet e çajit kurues shtuam edhe bimë që mbrojnë zemrën. Nuk përdorim vetëm një bimë, por duke ditur vetitë e përafërta të bimëve mjekësore, kemi kompozuar këtë çaj, që redukton acidin urik të ngritur, i cili jep edhe probleme në veshka, si dhe të sjellë një funksionim të mirë të qarkullimit të gjakut në arterie dhe vena. Aty kur gjaku qarkullon lirshëm, shkojnë edhe lëndët ushqyese dhe

oksigjeni. Pacientët duhet të pinë një gotë çaj që ne e përgatisim me bimë mjekësore në çdo vakt. Ne në kompozimin e këtij çaji futëm bimë që të mbrojnë edhe zemrën. Lëvorja e shelgut është një tjetër trajtim që përdorim për pacientët, pasi hollon gjakun. Edhe vaji i sinapit është një preparat shumë i mirë, që nxit qarkullimin e gjakut dhe ndihmon në kurimin e artritit. Zgjidhja e problemit të artritit reumatoid është e dukshme brenda një periudhe kohe shumë të shkurtër, pra brenda një jave



10

këshilla për të eliminuar stresin nga jeta juaj

Sigurisht që në jetën e përditshme ne shpesh hasim shumë stres që na bën të ndihemi tmerrsisht keq. Çdo ditë e më tepër dëgjojmë njerëzit të thonë se ndihen të stresuar, çka ndikon në prishjen e ekuilibrit të jetës. Në mënyrë që ta gjejmë se çfarë mund të na e largojë këtë stres është të gjejmë disa mënyra të lehta dhe efektive për tu ndjerë më mirë çdo ditë. Më poshtë po japim dhjetë këshilla efektive që do ju ndihmojnë të menazhoni situatat stresuese në përditshmërinë tuaj.

1-NDALONI MENDIMET QË JU MËRZISIN.

Qëllimi i kësaj teknike është që të ndërprisni rrjedhën e mendimeve stresuese. Me ndërprerjen e rrjedhës së tyre ju ndryshoni pasojën. Shoqërojmë mendimet stresuese me një pasojë negative (lloj ndëshkimi). Çdo sjellje që pasohet nga një ndëshkim ka prirjen që të mos përsëritet.

2-ZGJIDHINI NJË VEND KU TË MOS JU SHOQËTOJNË E AS TË MOS SHOQËTOJNË TË TJERËT.

Mbështillni grushtin e dorës së majtë me një garzë ngjitëse. (leukoplast) Shtrihuni diku e prisni disa sekonda. Pastaj filloni të mendoni rreth problemit që ju shqetëson me qëllim që të provokoni mendimet e pakëndshme. Sapo ato të fillojnë e të vërshojnë në trurin tënd, thuaj "STOP" me sa zë të keni dhe çmbështillni leukoplastin. Mund t'ju dhëmb pakëz dora, por këtu qëndron lezetia. Fjala "STOP" e shoqëruar me dhimbjen e dorës shkakton ndërprerjen e rrjedhës së mendimeve stresuese.

3-SHTRIHUNI DIKU DHE LËRËNI VETEN TUAJ TË LIRË.

Mos i sillni mendimet e pakëndshme në mendjen tuaj në mënyrë të pavullnetshme. Thjesht lëroni mendjen tuaj të shkojë nga të dojë. Sapo mendimet e pakëndshme të fillojnë të shfaqen, thoni "STOP", me një zë normal dhe në të njëjtën kohë çmbështillni leukoplastin.

4-RELAKSOHUNI

Lëroni mendjen tuaj të shkojë nga të dojë. Mos u sforconi të mendoni. Sapo mendimet negative të shfaqen në trurin tuaj, mendoni fjalën "STOP". Çmbështillni njëkohësisht leukoplastin. Përsëriteni disa herë. Shtrihuni dhe lëroni mendjen tuaj të shkojë nga

të dojë. Sapo mendimet negative të shfaqen në trurin tuaj mendoni vetëm "STOP", pa e çmbështjellë leukoplastin.

5-SHTYJINI MENDIMET TUAJA SHOQËTËSUESE.

Në çdo kohë që ju e ndieni se po filloni të shqetësoheni, shtyjini mendimet tuaja, deri në atë periudhë të ditës, të cilën ju e keni caktuar për t'u marrë me shqetësimet tuaja. Kur në mendjen tuaj të shfaqen mendimet shqetësuese, jashtë periudhës ditore që ju keni caktuar për t'u marrë me to, zëvendësojmë ato. Fokusoni vëmendjen në atë punë që keni në dorë, apo në diçka tjetër përreth. Më e rëndësishmja. Përdoreni periudhën ditore të caktuar, për t'u marrë në mënyrë intensive me shqetësimet tuaja.

6-DETYRAT E PAKËNDSHME

Sa herë që në mendjen tuaj të shfaqen mendime negative, përfshijini energjikisht në kryerjen e ndonjë detyre që ju e konsideroni të pakëndshme si larja e dys-hemesë, fshirja e pluhurave, etj.

7-Shmangni mërzitjen e stresin

Studimet e bëra nga Johns Hop-



kins në vitin 2002, treguan se meshkujt të cilët zemërohen shpejt apo shfaqin shenja të dukshme mërzie si kundërpërgjigje ndaj stresit janë rreth tre herë më tepër më të prekur nga rreziku i zhvillimit të sëmundjeve të ndryshme të zemrës, në krahasim me meshkujt të cilët paraqesin përgjigje me zemërim më të ulët ndaj stresit.

Ata e rrisin rrezikun e tyre rreth 6 herë për të pësuar atak pas moshës 55-vjeçare. Një shpjegim i mundshëm ka të bëjë me lidhjen mes zemërimit dhe presionit të lartë të gjakut, të cilët së bashku shtojnë nivelin e stresit të një individ. Një këshillë: Pranojeni mërzinë si të pashmangshme, pas pak stresi do të rrokulliset poshtë nga supet

tuaja. Uluni me shpinën drejt dhe provoni të qetësoni mendimet tuaja, kjo do t'ju ndihmojë të relaksoheni.

8-LUFTONI ANKTHIN

Rreth 2 % e popullatës kanë përjetuar një lloj forme të krizës së panikut. Njerëzit me frikë/ankth të ndryshme (p.sh. agorafobi, frika ndaj insekteve apo mikrobeve), përjetojnë më shumë kriza paniku, sidomos kur vijnë në kontakt me stimulim (nxitjen) e frikës. Kriza të tilla kalojnë shpejt kur stimuli i frikës hiqet apo largohet nga pacienti. Kur krizat bëhen kronike, simptomat bëhen më të rënda dhe si rrjedhim dobësojnë jashtëzakonisht shumë sistemin nervor për disa ditë. Krizat e panikut zakonisht shfaqen në moshë të re (20-at) dhe femrat janë 2 herë më tepër në rrezik për të shfaqur kriza paniku sesa meshkujt. Zakonisht krizat e panikut ngatërrohen me atak zemre gjë që ndikon negativisht në vetë diagnozën e krizës.

9-PERPIQUINI TË JENI OPTIMISTË

Njerëzit optimistë kanë mundësinë ta reduktojnë rrezikun e vdekjes në 50 për qind krahasuar me ata persona të cilët janë të zhytur në pesimizëm. Individët të cilët e shohin jetën me një vështrim pozitiv janë më pak të stresuar, më tepër të zënë me punë që i mbushin me harmoni, janë më të qetë dhe më të shëndetshëm. Kështu qëndrojnë larg stresit dhe sëmundjeve mendore.

10-BËNI NJË JETË AKTIVE

Jeta aktive do ta mbante larg stresin, mundimet dhe shqetësimet e jetës së përditshme, dhe nuk do t'iu linte shteg për të gjykuar veten për çdo gjë që ndodh. Natyra dhe shoqëria janë aleatët më të mirë të një jete të shëndetshme.



Këshilla



Efektet e mrekullueshme të kafes së zezë në organizëm

Nëse përzieni kafën me pak vaj ulliri apo me gjalpë do të fitoni mjet të shkëlqyeshëm natyror për trup, i cili do të zvogëlojë celulitin në kofshë dhe në vithë. Kafja e zezë është më shumë kulturrë se sa pije, ndërsa në botë kjo është e njohur për shkak të bisedës, mënyrës së përgatitjes dhe shërbimit tradicional, disa madje do shtonin edhe thashetheme me një filxhan kafe. Por konsumimi i kafesë është potencialisht proaktivë kundër zhvillimit të diabetit tip 2 tek gratë

në moshë të re dhe ato në moshë mesatare. Yndyra e kafesë është e pasur me thartirën linoleike, e cila është një antioksidues i fuqishëm, ka efekt antikancerogjen dhe stimulon sistemin imunitar. Në të njëjtën kohë, ajo pengon edhe plakjen e lëkurës dhe ka veti anti-inflamatore. Ndërsa një filxhan kafe e bluar përmirëson pikërisht qarkullimin e gjakut në sipërfaqen e lëkurës. Dy studime të ndara të Universitetit të Harvardit të kryera në vitin 2011

kanë treguar që femrat të cilat pinë disa filxhanë kafe në ditë kanë rrezik më të vogël nga kanceri endometrial, derisa gjashtë filxhanë kafe në ditë reduktojnë për 60 përqind mundësinë që meshkujt të preken nga kanceri i prostatës.

Meshkujt që pinë dy deri në tre filxhanë kafe në ditë kanë 25 përqind më pak rrezik nga sëmundja e Parkinsonit sesa meshkujt që nuk konsumojnë kafe. Ndërkohë sipas një studimi të kryer nga Universiteti i Harvardit në 50 mijë infermiere, ka treguar që femrat të cilat kanë pirë katër filxhanë kafe kanë 20 përqind më pak probabilitet të vuajnë nga depresioni sesa ato që nuk kanë pirë aspak kafe. Kurrsesi nuk duhet ta teproni, dy deri tre filxhanë kafe në ditë janë të mjaftueshëm.



Forconi imunitetin duke konsumuar çaj bliri

Vlerat shëndetësore të lules së blirit përfshijnë aftësinë për të përmirësuar sistemin imunitar, pasi kjo bimë parandalon disa qeliza të dëmshme, qetëson organizmin, heq ankthet dhe ul tensionin e gjakut.

Çaji nga lulet e blirit është përdorur gjerësisht në mjekësinë tradicionale popullore të shumë vendeve në botë. Ky çaj ka një shije të veçantë dhe aromë dehëse, por gjithashtu ka një nivel të lartë përbërësish të çmuar, flavonoidë dhe substanca të tjera që e bëjnë blirin si një bimë shumë të besueshme në treg. Një nga përdorimet më të gjera të çajit të lules së blirit është kundër ankthit. Ky çaj ka aftësi qetësuese kundër stresit mendor. Nëse vuani nga luhatjet e humorit ose stresi kronik, një filxhan me çaj bliri është zgjidhja më e zgjuar. Antioksidantët që gjenden tek bliri shërbejnë si luftëtarë kundër radikaleve të lira, duke i larguar ato dhe përmirësuar shëndetin tonë të përgjithshëm. E gjithë kjo parandalon sëmundjet kronike. Përbërësit dhe acidet që gjenden tek bliri çlirohen menjëherë në çaj duke nxitur djersitjen. Kjo është një mënyrë shumë e mirë për të larguar toksinat nga trupi. Së bashku me kripërat e tepërta, yndyrat, ujin dhe substancat e huaja. Këto cilësi e bëjnë blirin shumë të çmuar në rastet e sëmundjeve me temperaturë të lartë, pasi e ul atë. Përveç nxitjes së djersitjes dhe uljes së temperaturës, lulja e blirit jep një kontribut të veçantë në luftimin e simptomave të të ftohtit, gripin, inflamacionit në gojë dhe traktin respirator.

Çaji i lules së blirit të ndihmon edhe me kollën dhe fytn e trazuar, duke i dhënë fuqi sistemit imunitar. Ata që vuajnë nga dhimbjet e kokës, të shkaktuara nga tensioni dhe simptomat e tjera të inflamacionit duhet të konsumojnë çaj bliri dhe të eliminojnë dhimbjet nga artriti apo simptoma të tjera. Siç largon problemet nga rrugët e frymëmarrjes, ashtu ul tensionin e gjakut duke parandaluar një sërë problemesh përfshirë dhimbjet e kokës. Nëse keni stomak të lënduar, fryrje apo shtrëngime, atëherë mos i kurseni vetes një filxhan me çaj bliri sepse do të ndiheni mirë menjëherë. Doza maksimale e këtij çaji është tre filxhanë në ditë. Gratë shtatzëna nuk duhet të konsumojnë çaj bliri sepse përbërësit e lules mund të ndërveprojnë negativisht me barrën e tyre.

KOMUNIZMI

Dalin dokumentet, kur klerikët ‘predikonin’ kundra komunizmit

Fatmira Nikolli

1948, personazhet kryesore të Kryengritjes së Zhapokikës dhe dosjet voluminoze

4.-PP. Në mbledhjen që kemi bërë në dyblen e Baba Kasos kemi bërë ndarje pune si ma poshtë:

a) Mbase unë jeshë element i dyshimtë dhe survejohesha nga organet e pushtetit, mu nagrkua vetëm ana axhitative n'lemenat që njëfishin prej meje ose duhej t'ishin elementa me siguri kundra pushtetit.





b) Bab Shefqeti si kryetar i këtij grupi dhe si njeri që gëzon një influencë të madhe në popullin e N/Prefekturës Tepelenë dhe jashtë rrethit të saj, ju ngarkua rë propagandonte në besnikët e t'afërmit e tij kundra pushtetit, se teqeja e tij ishte qendër që frekuentohej prej qindra njerzësh e sidomos nga ata të krahinës së Buzit, e cila dhe gjatë luftës ka qenë e lidhur me Ballin Kombëtar dhe Baba Shefqeti e ka drejtuar dhe n'atë kohë popullin e kësaj krahine kundra Lëvizjes.

c) At-Gjergj Suli ishet caktuar për detyrë që të punonte në krahinës e Rëzës tepelenës (Labovat, Lekël, etj) dhe të mundohet të grumbullonte njerëzit e pakënaqur rreth këtij grupi.

d) Jashar Halili, ky ishet ngarkuar të punonte në rrethin e tij në katundin e Dames dhe të ndërliedhej me Dëshni... se aty ka patur miq ai si Maliq Psarin dhe elementë të tjerëq kundërshtarë të këtij Pushteti.


Dh) Neki Rexhua. Ky kishte për detyrë që të punonte në katundin rreth [për qark Tepelenës dhe të bënte që atë punë që do bëjshin...

4.PP. Në muajin korrik të këtij vjeti me rastin e ndimit të kartmonedhës së vjetër në të reja jam takuar në Tepelene me Surja Bej Vasjarin dhe të dy bashkë shkuaam në shtëpun e Jashar Halilit dhe biseduam rreth situatës ndërkomëtare. Surja Beu na tha se anglo-amerikanët kanë vendosur ndrrimin e këtij regjimi, grekët të lihen të LIRË...



Tepelena gjatë regjimit diktatorial, si u dënuan me vdekje prifti e baba Shefqeti

dhe më gjerë. Konkretisht, janë identifikuar personazhet kryesore të Kryengritjes së Zhapokikës në gusht të 1948 dhe dosjet e tyre hetimore gjyqësore, formulare, të përpunimit, mes të cilëve ajo e Atë Gjergj Suli, Baba Shefqet Mahmutit, etj. Ekspozohen treguesit alfabetikë që mbante Sigurimi i Shtetit për të përndjekurit në zonën e Tepelenës; statistika të të burgosurve të 1945, mes të cilëve disa dosje formulare, si ajo e Selahudin Totos; dosje informative të të pushtatarve, të përndjekurve dhe statistika të detyruara të tyre,



“Baba Shefqetit iu la zona e Buzit, At Gjergj Sulit zona e Leklit e Labovatis”


raporte të elementit antiparti, ku dokumentohet survejimi i personave të internuar, lista të Sigurimit me të arratisurit dhe të vrarët në kufi; raporte informative për banda diversantësh dhe dosjet e Sigurimit të Kampit të Bëncës. Për herë të parë ekspozohen regjistrat e përpunimit të mbarë zonës së Tepelenës, si dhe dosjet

voluminoze hetimore gjyqësore të grupit me të cilin u dënua poeti Trifon Xhagjika, ato të Neim Pashës, Zenel Shehut e dhjetëra të tjerë. Të gjitha materialet që dokumentojnë përndjekjen, rezistencën dhe masat që e pasuan ekspozohen në mjediset e Autoritetit, pranë Gardës së Republikës.

AIDSSH ka kryer kërkim të thelluar mbi viktimat dhe të përndjekurit e kësaj zone nga periudha 1945-1968, në dokumente, indekse alfabetike dhe statistika. Të gjitha materialet e sipërmendura janë deklasifikuar. Të interesuarit mund të plotësojnë formularët e kërkesës për informim, konform ligjit 45/2015 për t'i lexuar këto dokumente. Veç paraqitjes në mjediset e Autoritetit, materialet do të ekspozohen edhe në Tepelenë, më 23 gusht 2018, në kuadër të organizimeve të AIDSSH me partnerë, për Ditën Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totali-

DEBATI

Lame: Flamuri grek mbi kalanë e Janinës një kiç, Ali pasha kthehet përmbys në varr



Studiuuesi Artan Lame (sot mban detyrën e drejtorit të ALUIZNI-t) ka bërë një postim në profilin e tij zyrtar në Facebook, për kalanë e Janinës e Pashain e Tepelenës.

Jo pak ironik, siç është gjithëherë ai, Lame thotë se teksta sheh flamurin grek mbi kalanë e Janinës, mendon se “Flamuri grek mbi kullat e kalasë së Janinës. Duket pak kiç ai flamur mbi ato kulla, se gati asgjë s’e lidh Janinën me Greqinë”.

Shton jo pa ironi edhe se “ne shqiptot pak ose aspak bëmë për ta mbajtur atë qytet këndeje kufirit në ato vite që ndaheshin sinorët e shteteve”, por për të me gjasë “Aliu i Hankos, që tani u shërben grekëve për të ndjellë turistët, ndoshta kthehet përmbys në varr kur sheh flamujt me kryq të kaltër që valojnë përreth kullave të sarajeve të veta, por atë meriton”. Pore nëse ne do të suleshim për të kërkuar në “Facebook” Janinës, Lame na kujton se “Historia ndëshkon jo të padrejtë, por të pazotët”

POSTIMI

Përsiatje flamujshe.

“Pashait ia hodhën turqit, grekët e shqiptarët që e lanë në baltë”



Bajraku i Junanit mbi karakoll të Janin' kalasë. Ose e thënë në shqipe më të llagartë: Flamuri grek mbi kullat e kalasë së Janinës.

Duket pak kiç ai flamur mbi ato kulla, se gati asgjë s’e lidh Janinën me Greqinë.

Ndoshta më shumë aty do shkonte bajraku i Baba Dovletit, që të paktën e mbajti qytetin për plot 500 vjet, i dha fytyrën osmane që e ka edhe sot dhe në fund e lëshoi me luftë.

Natyrisht qe patriotet e Fb-së

do sulen të thonë se aty do shkonte flamuri me zhgabë, mirëpo me thënë të drejtën, ne shqiptot pak ose aspak bëmë për ta mbajtur atë qytet këndeje kufirit në ato vite që ndaheshin sinorët e shteteve.

Aliu i Hankos, që tani u shërben grekëve për të ndjellë turistët, ndoshta kthehet përmbys në varr kur sheh flamujt me kryq të kaltër që valojnë përreth kullave të sarajeve të veta, por atë meriton.

Historia ndëshkon jo të padrejtë, por të pazotët. Dhe Aliut, asllanit të Janinës, ditën e larjes së hesapeve, ja hodhën të gjithë. Ja hodhën turqit, që ai i kish shfrytëzuar gjithmonë, ja hodhën grekët që ai i kish nënçmuar po aq, madje ja hodhën dhe shqiptarët që, siç e kanë adetin, të lënë në baltë kur kërcet dyfeku...

Fundi i historisë, mbi kala të Janinës valon e do valojë bajraku i grekut, Aliu do shërbejë si dor-dolec trendy për të bërë foto erotike me Vasiliqinë, turqit pasi humbën sulltanët e vërtetë sajonë sulltanë me kravatë, ndërsa në... arnautët zulmëdhej, neve s'na vë njeri në refene.

tare, me praninë e komunitetit vendas. Kjo ekspozitë komplekse synon të inkurajojë dialogun lokal mbi të shkuarën, duke e vënë fokusin në ngjarje të spikatura të zonës, që i ridimensionojnë figurat dhe nxisin reflektim.

DËNIMI

“GSH” sjell sot, edhe një pjesë nga dokumenti që i dënon klerikët e lartpërmendur.

“Përveç të pandehurvet Nako Dede dhe Zagoll Saliko për të cilët trupat gjykues nuk formon bindje që ta kenë kryer me koshiençë të plotë fajin e tyre dhe si mbas nenit 40 të ligjes nr.382 datë 2/4/ XII/ 1946 ju akordohen shkaqe lehtësore gjenerike.

Për këto arsye:

Gjykatra bashkërisht duke parë dhe nenin 4 të ligjës nr.372 datë 12/12/ 1946 vetëm për të pandehurit për fajet e natë treguara dhe në bazë të dispozitave ligjore të mësipërme i dënon si më poshtë:

Për të pandehurit At Gjergj Suli, Zenel Shehu, Baba Shefqet Haderi, Sali Neim Guri, Gaqo Muzina, Namik Haderi e Rako Çekën me VDEKJE, bjerjen e të drejtave civile e politike. Konfiskimi i pasurisë së Sail Neim Gurit, konfiskimin e ½ e pasurisë dhe parat e ardhura nga Sillopgu Gaqe Muzinës; konfiskimin e ¼ të pasurisë së Zenel Shehut. Për të pandehurit Tehmo Muzha e Vasilaq Xhelu me privim të lirisë për jetë dhe konfiskimin e ¼ e pasurisë të Themo Muzht si edhe parat e ardhura nga Sillopu, për të dy bjerjen e të drejtave civile e politike. Për të pandehurit Xhelu Shamenti e Polo Nako me nga 20 vjet privim lirie dhe punë të detyrueshme, bjerjen e të drejtave politike për nga 5 vjet secilit.

“N'DRITË”, ISH-KAMPI I INTERNIMIT

Këtë 23 gusht, në ish-kampin e përqendrimit në Tepelenë, HARABEL në bashkëpunim me Autoritetin e Sigurimit të Dosjeve me IIPP do të kurojë paraqitjen e tri pjesëve të rëndësishme të artit: “Edhe muret kanë veshë” nga Alketa Xhafa Mripa; “Sikur mama” dhe “I përkasim njëri-tjetrit” nga Ema Andrea, Ervin Kotori, Gjon Radovani dhe Agron Tufa. Në vijim do të zhvillohet një koncert muzikor nga “Asgjë Sikur Dielli” dhe “3 Musketjerët”. Gjithçka si një festë e jetës mbi dhimbjen dhe vdekjen, kushëtzuar nga ish-regjimi komunist shqiptar. Kjo do të bëjë paraqitjen më sfiduese të artit bashkëkohor nga ana jonë deri më tani, brenda një kampi të mëparshëm përqendrimi të hapur për herë të parë për publikum e gjerë, duke mprehur kujtesën tonë historike ndaj dhimbjes brutale mendore dhe fizike, frikës dhe mungesës së lirisë; në një ditë me diell gushti, ndërsa jeta ecën ngadalë drejt pranimit dhe faljes, drejt dritës.



Ish-kampi i internimit i Tepelenës i përngjan një kampi përqendrimi në të cilin janë humbur qindra jetë.

Zanafillën e ndërimit të kompleksit muzeal e shënojnë dy kazerma të ndërtuara nga ushtria fashiste italiane në vitin 1939. Kazemat shërbyen si bazë ushtarake e ushtrisë fashiste në luftën italo-greke. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjes së diktaturës komuniste në Shqipëri, në vitin 1949 ky reparat ushtarak u shndërrua në kamp internimi dhe shërbeu si i tillë deri në vitin 1953. Nga viti 1953 deri në vitin 1990 ai shërbeu si reparat ushtarak për ushtrinë e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe pas vitit 1990 ky kompleks humbi çdo funksion.

Në kampin e Tepelenës kanë ndërruar jetë rreth 300 fëmijë, kryesisht nga uria dhe keqtrajtimi. Fëmijët përfunduan në këtë qendër brutale internimi me të vetmin “faj” se ishin fëmijë ose nipa të prindërve, gjysheve ose kushërinjve që për pushtetin popullor ishin kategorizuar si armiq politikë. Këtyre fëmijëve u hoq edhe e drejta e pasjes së një varri, duke i varrosur buzë lumit, me qëllim që ujërat e Vjosës t’ua merrnin eshtrat më vete, duke i zhdukur kështu gjurmët e këtij makabriteti.

Qëllimi i projektit është ndërgjegjësimi i opinionit publik për historitë e dhimbshme të këtij kampi dhe të gjitha jetëve të pafajshme të humbura në të.

FORUMI TRASHËGIMISË KRITIKON MINISTRINË PËR KISHËN E DHËRMIUT

Kisha e uniute e Dhërmiut u bë e njohur për publikum vite më parë, kur përpjekja e qeverisë për ta kthyer në identitet hasi në rezistencën e komunitetit ortodoks të zonës, duke çuar në një përplasje që ia mbërriti deri në Ministrinë e Jashtme helene. Por, dy vite më vonë, kur debati është shuar e kisha është drejt përfundimit, ajo që vihet në diskutim është cilësia e

jekte të cilat kur bota i realizon, nuk dallohet origjinali nga kopja”.

Sipas Forumit, çështja është se këtu kopja është gjithnjë tepër banale dhe e shëmtuar (tregues për këtë është fjala bie riprodhimi skandaloz i Shtëpisë së Flamurit në Korçë bërë me para të buxhetit të shtetit). Mjafton fotografia poshtë, të cilën e poston me kre-



punimeve. Në një postim të datës 17 gusht, ministrja e Kulturës bënte me dije se “Në Dhërmi, siç premtuam, po mbyllet rindërtimi i Kishës së Shën Thanasit mbi gjurmët e mbetura që nga vitet 60 kur regjimi vendosi ta shkatërrojë”. Postimi i saj u shoqërua edhe nga disa fotografi të punimeve.

Por puna e bërë është kritikuar nga Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Në një postim të tij, Forumi shënon se “si të mos mjaftonte paaftësia për restaurim të mirëfilltë, Ministria e Kulturës nuk është në gjendje as të riprodhojë objekte të thjeshta sikurse kisha në Dhërmi, ob-

nari anekdotike Kumbaro, të kup-tohet që përveç elementeve, sikurse muratura ‘dekorative’ apo kambanorja trashanike, as edhe një hark normal porte, kompanitë e përzgjedhura nga zonja nuk janë në gjendje të riprodhojnë”. Forumi shton se harku origjinal i kishës kishte dy elemente të kurbëzuar e të latuar nga gdhëndës të mirëfilltë, ndërsa i riu është i bërë i bret me një radhë gurësh banalë prej muratorësh. “Mëkat, sepse ky objekt ku u harxhuan miliona, do mbetet aty si dëshmitar i mandatiit okult të kohës së keqe Kumbaro”, e mbyll reagimin Forumi.

Opinion i Ditës

Kryemodel i sjelljes politike

Nga Dr. Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

... dhe fishekzjarrëve propagandistike, me mirësjelljen e duhur diplomatike dhe pragmatizmin për zgjidhjen e problemeve, Merkel deklaroi se ndonëse nuk pritej ndonjë gjë e veçantë, ai takim ishte mjaft i rëndësishëm. Po ashtu, në përfundim, pa atë mediatizimin e zhurmshëm ajo njoftoi se bashkë me Putin kishin përcaktuar hapa dhe etapa konkrete për trajtimin e menjëhershëm në nivelet përkatëse dy dhe shumëpalëshe të problematikës shpërthyesë ndërkombëtare, ku Gjermania dhe Rusia kanë roli të veçantë.

Në fakt, shumë analiza dhe studime mbi lidhshimin e konsiderojnë sjelljen e veçantë politike një nga «sekretet» e suksesit dhe jetëgjatësisë politike të Kancelares Merkel.

Edhe pse gjatë tre viteve të fundit jo pak gazetarë, analistë dhe ekspertë të ndryshëm politikë kanë paralajmëruar fundin politik të Merkel, gruaja më e fuqishme e botës vijon vitin e 13 të kancelarisë. Ia ka kaluar dhe Thatcherit për nga jetëgjatësia si shefe qeverie dhe pritet të thyjë rekordin e paraardhës të saj legjendar Helmut Kohl.

Krahas themeluesit të Gjermanisë moderne Konrad Adenauer dhe «Babait» të Gjermanisë dhe Evropës së ribashkuar Helmut Kohl Merkel është liderja më jetëgjatë e CDU-së, Partisë Kristian Demokratike Gjermane me 19 vjet në krye të saj.

E kjo jo vetëm nga ana sasiore, por dhe cilësore; sidomos lidhur me lidhshimin e guximshëm që ka treguar në kapërcimin e 10 krizave serioze ndërkombëtare me emra drithërues bankare/financiare, falimentit grek dhe italian, azili, terrorizmi ndërkombëtar, etj.

Kur filloi karrierën politike më 1990 si ministere mjedisi, vështirë që Merkel ta kishte menduar se do të bëhej Kancelare dhe mbrojtëse e madhe e Europës; deri sa në zgjedhjet e parakohshme në shtator 2005 nxori jashtë loje Kancelarin karizmatik Gerhard Schröder; me vonë Merkel mposhti në «fairplay» politik emra të tjerë të ngjallës social-demokratë - Presidentin e tanishëm Walter Frank Steinmeier, pastaj Peer Steinbrück dhe vitin e kaluar ish-presidentin e Parlamentit Evropian, Martin Schulz. Por dhe «burra» të tjerë politikë të vetë CDU-së, jo politikë kanet gra filluan të zënë vend shumë më të madh se më parë, kur «numëroreshin me gishta».

Në fakt, sjellja politike «Merkel» shkon shumë më thellë dhe më larg se manierat e jashtme, look-u, veshja dhe aksesoret, korrejtia dhe rigoroziteti ndaj kodeve etike dhe protokollare. Ajo nuk kufizohet vetëm në raste të tilla të spikaturat si të nesërmen e largimit të liberalëve dhe social-demokratëve nga bisedimet për



krijimin e koalicionit të ri, sapo hyri në Bundestag Merkeli shkoi te liderët e tyre në sallë dhe i përshëndeti ngrohtësisht, natyrisht dhe me keqardhjen e rastit, këtë të fundit kryesisht me «gjuhën e trupit». As dhe vetëm në vlerësimin dhe nderimin e saj të vazhdueshëm e jo thjesht ceremonial për politikantë kundërshtarë të tanishëm dhe ata paraardhës.

Ky kryemodel i sjelljes politike buron mbi të gjitha nga integriteti i saj absolut politik dhe qytetar. Në 30 vite të lidhshimit të saj politik, jo vetëm nuk ka asnjë rast të vetëm skandalesh dhe aferash, por as aludime dhe dyshimet më të vogla për raste korrupsioni, shpërdorimi të postit etj.

Kjo sjellje politike mbështetet mbi të gjitha në frymën dhe vokacionin e theksuar evropian të Merkel, si busull e përhershme politike; në tolerancën, kompromisin, mirëkuptimin, besimin dhe zgjidhjen me durim dhe hap pas hapi të problemeve.

Ashtu si pohojnë vëzhgues të ndryshëm politikë, profesioni si fizikant ka ndikuar te Merkel për të mbujtur karakterin dhe personalitetin e saj me disiplinën, saktësinë, durimin, gjakftohtësinë, dhe qetësinë që të jep kjo shkencë. Gjithashtu, në debutimin e saj poli-

tik, Merkel e kuptoi shpejt se ligërimi publik, polemikat dhe debatet e forta nuk ishin siç thuhet në Gjermani «elementi apo pika e fortë e saj».

Me gjithë fitoret e shumta politike dhe zgjedhore, Merkel nuk e njeh triumfalizmin politik, arrogancën, mendjemadhësinë apo maninë për t'u dukur e për të pranuar elozhe; ajo i ka zëvendësuar ato me urtësinë, përmbytjen, mençurinë, finesën dhe modestinë politike. Kjo shpjegon suksesin e saj në drejtimin e koalicionit qeveritar për një mandat me liberalët e FDP-së dhe për dy mandate radhazi me kundërshtarët tradicionalë social - demokratë, me të cilët tani qeveris për herë të tretë.

Si përfaqësuese e një shkollë të re politike, Merkel dallohet qartazi nga gjuha tejet e kujdesshme, rrjedhojë e një logjike racionale, pozitiviteti, etike, respekti dhe bashkëpunimi me aleatët dhe kundërshtarët politikë e deri te vëmendja ndaj halleve të përditshme të njerëzve dhe lidhjet e natyrshe me ta.

Fjalori i saj i thjeshtë politik është përherë i përmbytur, i zgjedhur me kujdes, pa epitete, insinuatë, ironi e ca më pak sarkazëm, pa lëndime dhe sulme politike e ca më pak personale ndaj

askujt, sidomos ndaj kundërshtarit politik, gjerman apo të huaj; dhe kur ata nuk kanë të drejtë morale apo sado të «krisur e të këqij» qofshin; kërko në jetën e saj të gjatë politike dhe nuk gjen asnjë rast të vetëm sado të vogël të kësaj natyre!

Ja pse dhe në intervistën e saj televizive në prag të pushimeve verore më 20 Korrik, Merkel u shpreh kundër «erozionit të gjuhës, e cila shpreh mendimin dhe kësajsoj shkohet drejt dështimit ose veprimt efikas; sipas saj, është ky i fundit që duhet të «sundojë» dhe jo gjuha sulmuese.

Kjo u pa qartë muajin e kaluar gjatë situatës absurde kaotike që krijoi «simotra» bavareze e CSU-së dhe lideri i saj, ministri i Brendshëm Federal Horst Seehofer me mesazhe populiste dhe ultimatumet të papara në politikën gjermane; por, Merkel iu përgjigj vetëm me pohime pozitive dhe kryesisht me demarshë dhe hapa politikë/diplomatike; brenda një jave, ajo organizoi dy samite të BE-së, takoi homologët e saj kryesorë deri te kompromisi shpëtimtar lidhur me krizën e azilit për të cilën kemi shkruar më parë dhe doli politikisht e fituar.

Ndërsa tri javë më parë, në kulmin e polemikave të ashpra poli-

tike dhe mediatike pas dorëheqjes nga Kombëtarja gjermane, Merkel i doli hapur në mbrojtje Mesut Özil, Kampionit të Botës në futboll, gjermanit me origjinë turke; madje e vlerësoi atë si shembull të integritetit të suksesshëm; duke respektuar vendimin e tij, Kancelarja dhe njëherë «uli ndjeshëm gjakrat» si në Gjermani ashtu dhe në Turqi.

Këtë sjellje politike Merkel e rrezaton dhe gjatë interpelancave në Bundestagun gjerman, te dëgjon e qetë kritika dhe sulme të ashpra; i shoqëron ato hera herës me një buzëqeshje të lehtë, por pa asnjë ndërhyrje; vetëm në fund të interpelancës, pa përmendur emrin e folësit por vetëm temën apo kritikën përkatëse, ajo jep përgjigjet e veta me shpjegimet e rastit. Pa përdorur asnjëherë fraza mohuese apo përcmuese ndaj askujt, por me finesë, qetësi dhe elegancë pohon vizionet dhe alternativat e saj të ndryshme ose të kundërta.

Modestinë, thjeshtësinë, natyshmërinë dhe përlulesinë karakteristike Merkel i shfaq dhe me median dhe shtypin, në intervistat dhe bisedat me ta, larg megalomanisë, gjuhës së drunjtë, arrogancës, insinuatave dhe epitetëve të papranueshme ndaj medias, madje dhe kur kjo e fundit «ia bën borxh». Po të mos e njohësh në daljet gjithësi tejet të kursyera televizive dhe mediatike, me vështirësi e dallon se përballë gazetarit është Kancelarja emblematike e shtetit më të fuqishëm evropian.

Kancelaria e saj e suksesshme 13-vjeçare, bashkë me, pse jo, dritë-hijet e veta dhe erozionin zgjedhor tregon se shumica e elektoratit gjerman ka ende nevojë për një liderë të tillë, jo të zhurmshme, me bujë dhe megalomane, jo të batutave dhe e spektakleve boshe mediatike, por «me këmbë në tokë».

Duke parë këtë dhe shumë cilësi të tjera rrezatuese të lidhshimit Merkel, shumë ekspertë dhe analistë të huaj tani pohojnë se nuk është çudi që «Nëna e Gjermanisë» siç e konsiderojnë, një ditë jo të largët të bëhet dhe Nëna Politike e Europës së re.

Ndaj, sjellja politike «Merkel» mbetet alternativë bindëse në realitetet e sotme sfiduese gjermane dhe ndërkombëtare dhe pengesë madhore për forcat populiste dhe ekstremiste në Europë dhe më gjerë.

Së fundi, prej kësaj sjelljeje politike mund të mësojnë shumë edhe politikanët tanë, që pa mohuar shembujt dhe rastet pozitive kanë jo pak deficite në këtë fushë. Për më tepër, të mësohet nga kjo sjellje politike nuk kërkon kushte, kritere, rregulla, projekte, fonde, negociata, por vetëm predispozicion, frymë dhe përgjegjësi politike/ qytetare ndaj publikut. Për më tepër, kur kjo sjellje politike është e rëndësishme për Gjermaninë, ajo është një «Muss» pra domosdoshmëri dhe për politikanët tanë të çdo niveli.

Opinion *i* Ditës

Këshilla timonierit të makinës së lodhur

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

...edhe një kilometër larg.
2. Mos i dëgjo pasagjerët e dy rreshtave të parë të furgonit (anëtarët e kabinetit) që drejton, kur të thonë sa drejt i jep makinës dhe sa bukur i merr kthesat, apo sa me zgjuarsi e rrit shpejtësinë në rrugë ndërkombëtare. Miklimi i puthadorësit është helm që nuk shihet kollaj edhe prej më të përgjegjshmit, pasi i depërton pa u ndjerë në vesh nga lezeti i "furçës". Rrezikon të të verbohen sytë nga vetëkënaqësia dhe të përfundosh në kanal.

3. Shiko të parët pasagjerët e varfër të rreshtave të fundit të furgonit. Ke 93 mijë punonjës të administratës publike. Nga ata, 89 përqind jetojnë me djersën e ballit dhe vetëm me rrogën që marrin në shtet. Fillllove të bësh diçka reale për ta, kur shkarkove në një ditë më 14 qershor 2017 drejtuesit e Hipotekave, apo kur më 31 korrik 2017 shkarkove drejtorët e spitaleve publike. Pastaj, me ç'duket, u lodhe rrugës. Mos provo më kur të ndihesh i lodhur për punonjësit e ndershëm të shtetit që do të bësh, as i zhgënjyer prej pakurajos së sotme të tyre. Ajo ka shumë arsye... Duke e lënë punonjësin e ndershëm të shtetit pas dore, ke krijuar sulltanë të vegjël tek ata që u ke besuar edhe ministri apo drejtori të rëndësishme. Këta sulltanë po e keqtrajtojnë këtë punonjësit përditë. Ke një reformë të haruar të administratës publike, të cilën duhet ta fillosh, duke e kapur mirë dashin për brirësh. Nise, duke rritur numrin e nëpunësve civilë nga 16 mijë që e ke tani në 30 mijë brenda 31 dhjetorit 2019 dhe mirato ligjin për përgjegjësinë materiale të nëpunësit publik, që të ruash vreshtat.

4. Nuk e ke luksin të ndalosh në rrugë për të ndërruar gomat, as edhe të kërkosh tek ndërkombëtarët remont kapital të makinës së lodhur dhe tejet të amortizuar të quajtur shtet. Mos mendo se boja e gjyqtarëve dhe prokurorëve të skualifikuar do të shkëlqejë mjaftueshëm për të të besuar njerëzit propë timonin 996 ditë më vonë (qershor 2021).

5. Boll ujite "lulet" e qendrave të qyteteve dhe lungomareve të bregdetit. Fasadat kanë shkëlqim që nuk e "nrohohin" motorin e makinës tënde të lodhur, në ditë të acarta, kur nuk dëgjon të ndizet.

6. Paketa e ndihmës së parë nuk funksionon vetëm me rikonstruksione reparatesh dhe shërbimesh spitalesh qendrore publike, që dalin aq bukur në televizion. Ajo ka nevojë të jetë e plotë në çdo "makinë të lodhur" të spitaleve të qyteteve të humbur, apo fshatrave malore.



7. Thonëse mrekullitë e kësaj bote janë shtatë. Mrekullia e "të bërit shtet", për të cilën ke kërkuar aq fort të ta japin të vetëm timonin, është shumë e thjeshtë. E thotë një plak i

Niviqës: "dëgjo nga thellësia e tokës". Çdo xhenerik i vjetër makinë, më parë zhgërryhet në baltë dhe i buçasin veshët duke ndenjur me orë poshtë makinës, për t'ia kuptu-

ar asaj se nga se i vjen "lodhja". Nuk të mjaftojnë orët që kalon duke lexuar mesazhet në celular, apo duke shkëmbyer batuta "vërtetësie" me komentues rrjetesh sociale në kompjuter, sado me vlerë të jenë ato për nga sensi i fjalëve. Vetëm "prekja fizike", bisedat me hallexhinj jo të përzgjedhur për ekranin e përzgjedhur televiziv, të zbresin thellë dhe do të të bëjnë të "dëgjosh zhurmat e tokës që rënkton".

Kërkoj ndjesë nga paplotësia e këtyre këshillave. Kam 22 vjet me patentë drejtimi automjeti dhe ndjej frikë përpara çdo kthesë që marr. Mendoj se kjo frikë më ruan dhe më bën të përgjegjshëm për jetën time dhe të atyre që kam në makinë.

Nuk e ke luksin të ndalosh në rrugë për të ndërruar gomat, as edhe të kërkosh tek ndërkombëtarët remont kapital të makinës së lodhur dhe tejet të amortizuar të quajtur shtet. Mos mendo se boja e gjyqtarëve dhe prokurorëve të skualifikuar do të shkëlqejë mjaftueshëm për të të besuar njerëzit propë timonin 996 ditë më vonë (qershor 2021).

HOROSKOPI

DASHI

Mbështetja e disa personave me shumë influencë do t'ju rrisin autoritetin. Do të keni dëshirë të udhëtoni dhe të shpenzoni para, por do t'ju vijë keq nëse e bëni këtë të fundit. Kaloni disa momente të këndshme me fëmijët tuaj. Romanca do të udhëheqë zemrën dhe mendjen tuaj.

DEMI

Do të ndiheni shumë mirë fizikisht e shpirtërisht dhe për këtë arsye do të realizoni diçka të jashtëzakonshme. Sot do të keni aq shumë energji, sa mund të organizoni edhe një festë të madhe. Çiftet e martuara do të kalojnë një ditë të mrekullueshme dhe gjithçka të trishtueshme me tyre do ta lënë pas.

BINJAKET

Përpquni të relaksoheni në mbrëmje. Nëse keni ndërmend të investoni diku, duhet të shihni çdo gjë në mënyrë të detajuar. Sot do të harroni problemet dhe do të kënaqeni me familjen tuaj. Bëni kujdes të mos flisni ashpër nëse përfshihen në një konflikt.

GAFORJA

Njerëzit rreth jush do të tregohen shumë kërkues, por mos premtori më shumë se ç' mundeni. Sot do të keni mundësi të fitoni një shumë të konsiderueshme parash, por tregohuni të kujdesshëm dhe mos e lini këtë mundësi të shkëlqyer t'ju humbasë.

LUANI

Bëni kujdes me shëndetin, ushqehuni sa më shumë fizikisht. Familjarët tuaj do të mërziten me ju për shkak të disa sjelljeve të pamatura. Sot ka gjasa të takoni dikë që do t'ju rrembejë zemrën.

VIRGJERESHA

Sot t'ju vijnë për vizitë disa miq, të cilët do t'ua gjallërojnë ditën. Tregohuni të vëmendshëm, pasi dikush do të flirtojë me ju. Tregohuni sharmantë dhe të edukuar ndaj atyre që shfaqin interes për ju.

PESHORJA

Disa ndryshime në look do t'ua përmirësojnë shumë pamjen. Ka gjasa që një miqësi e thellë t'ju shndërrohet në dashuri. Mos e humbini ditën duke u marrë vetëm me një gjë të caktuar, por organizojeni më mirë atë.

AKREPI

Inkurajoni veten për të pranuar emocione pozitive si dashuria, shpresa, optimizmi, besnikëria. Sapo kjo të ndodhë, do të reagoni pozitivisht ndaj çdo situatë. Ka gjasa t'ju rriten përgjegjësitë familjare, flarë do t'ju shkaktojë tension.

SHIGJETARI

Mbështetja e disa personave me shumë influencë do t'ju rrisin autoritetin. Do të keni dëshirë të udhëtoni dhe të shpenzoni para, por do t'ju vijë keq nëse e bëni këtë të fundit. Kaloni disa momente të këndshme me fëmijët tuaj. Romanca do të udhëheqë zemrën dhe mendjen tuaj.

BRICJAPI

Presioni në punë dhe disa probleme në familje mund t'ju shkaktojnë stres. Kjo do të sjellë mos përqendrim në punë, ndaj përpquni të mos i kushtoni rëndësi. Do të takoni një mik të vjetër, me të cilin keni vite pa u parë.

UJORI

Sot nuk do të ndiheni aspak energjik, por bëni mirë të përfshihen në disa aktivitete kreative, në mënyrë që të ndiheni të motivuar. Nuk është asnjëherë vonë për të planifikuar të ardhmen.

PESHQIT

Bëni kujdes me ato që konsumoni. Shmangni ushqimin në rrugë. Nëse keni ndërmend të investoni diku, është dita tuaj me fat pasi do t'ju sjellë mjaft të ardhura. Përpquni ta shfrytëzoni pasditen me miqtë tuaj, pasi do t'ju bëjë të ndiheni shumë mirë.

Dje në "Zëri i Amerikës"

Refugjatja e parë nga Afrika drejt Kongresit amerikan

Ligjvënësja e shtetit të Mine sotës, 35-vjeçarja Ilhan Omar, është një hap më pranë hyrjes në histori, si refugjatja e parë nga kontinenti i Afrikës dhe gruaja e dytë myslimane që zgjidhet në Kongresin amerikan. Refugjatja nga Somalia po përpigjet të zëvendësojë Keith Ellison, myslimanin e parë amerikan në Kongres, i cili aktualisht përfaqëson distriktin liberal të Minneapolisit, që mbështet demokratët. Mbështetësit e zonjës Ilhan Omar shpresojnë që ajo të ketë ndikim në debatin për imigracionin dhe në politikën e jashtme amerikane.

Pitorja historike të Ilhan Omarit në zgjedhjet paraprake për të përfaqësuar Distriktin 5 të Minesotës në Kongresin amerikan, u realizua bazuar mbi një mesazh të thjeshtë.

"I përkas gjeneratës së mijëvjeçarit dhe kam borbxe studentore... unë jam refugjate dhe qiramarrëse."

Mesazhi ishte se ajo i kupton të rinjtë, votuesit liberalë që përbëjnë një pjesë të madhe të distriktit të saj. Ishte një mesazh që solli fitore në 2018 dhe dy vjet më parë, kur fitoi zgjedhjet e para në legjislaturën e shtetit. Khalid Mohamed është votues somalez-amerikan.

"Para Ilhan, shumë prej nesh nuk e dinin se çfarë qeverisjeje kishim, por me zgjedhjen e saj, shumë prej nesh kemi filluar t'i kushtojmë vëmendje."

Votuesi Khalid Mohamed pajtohet me synimet e zonjës Omar për të rritur pagën minimale federale dhe reduktuar borxhin e studentëve. Ai ishte një prej mijëra somalez-amerikanëve që votoi në zgjedhjet paraprake. Por profesori i Shkollës Humphrey për Marrëdhëniet me Publikun në Universitetin e Minesotës, Larry Javobs, thotë se votat somalez-amerikane janë vetëm një pjesë e suksesit të zonjës Omar.



"Votat e somalez-amerikanëve nuk janë të mjaftueshme për fitoren dhe sidomos në një garë ku votat ndahen me një tjetër kandidat somalez. Për herë të dytë zonja Omar ka arritur të ndërtojë një koalicion të gjerë që përfshin njerëz progresivë, që pajtohen me politikën e Bernie Sanders dhe nga ata që besojnë se Partia Demokratike duhet të bëhet më e larmishme dhe të mirëpresë zëra të rinj."

Zërat e rinj që kanë sfida të vjetra dhe të reja për t'u përballur: "Tani jam e përgatitur për t'u

organizuar kundër një administrate që po përdor politikën e frikës për të nxitur axhendat e tyre përçarëse dhe shkatërrimtare, në një kohë kur vendi ynë është në një udhëkryq të rrezikshëm", - thotë Ilhan Omar.

Aktualisht ajo është udhëheqëse e pakicës demokratike në Dhomën e Përfaqësuesve të shtetit Minesota dhe kundërshton ndarjet e familjeve në kufi; ajo është kritike e administratës së Presidentit Trump për ndalimin e hyrjes së myslimanëve në Amerikë.

Votuesi Khalid Mohamed shprehet se eksperiencia personale e zonjës Omar do të ndikojë tek debati në Kongresin amerikan për politikën e imigracionit.

"Ajo ka përjetuar luftën e të qenit refugjat dhe procesin e verifikimit, diçka që Donald Trump nuk e ka kuptuar mirë."

Ai shprehet që zgjedhja e zonjës Omar shërben si mesazh jo vetëm tek një komunitet i madh fetar, por në të gjithë kontinentin.

"Është arritje e madhe për

kontinentin, nëse ajo bëhet ligjvënësja e parë në Kongresin amerikan që ka lindur në Afrikë...mund të kesh qenë refugjate, dhe mund të kesh ardhur këtu si emigrante, por ke të drejta...mund të bëhesh çfarë të duash nëse punon në atë drejtim."

Kjo punë fillon për zonjën Omar pas zgjedhjeve të përgjithshme të nëntorit, që ka gjasa të fitojë, ndërsa rajoni që ajo kërkoi të përfaqësojë ka prirje të fuqishme pro kandidatëve demokratë.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.




INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomisë e Pune
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mapupassant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenja.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë art i të folurit
22. Një patriark bibliq.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.
32. Ekstremit në numërim.
33. Eshhtë bodrumi.

34. Steiger aktor.
35. Inicialet e Delon.
37. Eshhtë edhe ai Me Gropa.
38. Një mund të jetë autonom.
40. Në krye të evidencës.
42. Edgar Allan Poe.
44. Ekstremit në litar.
46. Giorgio i modës.
50. Janë malet me Akonkagua.
52. Janë ujërat e bregdetit tonë.

VERTIKAL

1. Novarro që qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishte qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat që prodhohen.
10. Eshhtë ai që gënjën për t'u bërë i njohur.
11. Një markë celulari.
12. Ushtrohej nga filibustierët.
16. Një përsiatje.
17. Agjenci Informativ Tiranë.
21. Një bretës pylli.
23. Një Gjon që qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum që qe pianist.
15. Një që lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipò
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitor i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.
42. Neill i Jurassic park.

VERTIKAL


35. E bukura e belle epoques.
37. Qe mbreti i ellëve
39. Farrow, aktore
40. Hagen rocshtar
41. Walter i Kush do ta vrasë Charley Verrik
45. Në fund majtas
46. Mund të preken nga mbusbi i Basedow
47. Ad... për të ngarkuarin me punë
48. Loach regjisor

VERTIKAL


2. Ishin grekët në trojë
3. Ishin palate të beut
4. Goodëin, ndihmësi i Nero Wolfe
5. Pak sinqeritet
6. Personazhet e Charles Schulz.
7. Kompozoi Mefistofele
8. Në radhë të parë.
9. Qytet zvicëran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos që qe pilot i Formula 1
15. Ekstremit në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërora
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimoze
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lemper, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

F E R M A N I T J N A
A K S I L O V A L E
R O N E P F R E N A T
A H I P O K R I T E T D
D E M O S T E N I K E
D I K A S T E R E T N O R
A M A L I A I Z E N E A
D E L E R A E O E
A R I E P I T E T E T
I O M A I D M A D H I
S R I R I E L I R E N T
T E R R O R I A R E N A T

FJALËKRYQI (2)

L U I S S P A M A L I A
A L K T R O B E R I A
P P E R I O D I K E N A
F I N A L J A A A R E N
R E P A R T E T N S I A
T E R E K S I P N
P A R E T T R U K E T U
A R I T R E A L K U P A
S T A N D E F I T I M E T
T A N D E M N E R E U R
A H O T E L E T T R A U
J U K A T E R A R M

SUDOKU

			7	4				
2			3	5	6		9	
	8			6	9	1		
	1	7		3				
8	9							
		2	1	4				
9							3	
	4					9		
		3	2					6

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	4	1	7	9	2	8	3	5
2	7	5	3	1	8	9	4	6
8	9	3	4	5	6	1	2	7
7	1	8	5	2	4	3	6	9
5	2	6	8	3	9	7	1	4
9	3	4	6	7	1	2	5	8
3	5	9	1	4	7	6	8	2
4	6	2	9	8	3	5	7	1
1	8	7	2	6	5	4	9	3

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

-Katër gazetave armiqësore duhet tu frikësohesh më shumë sesa mijra bajonetave.

-Kur njeriu e kupton që nuk është i ditur, ka hedhur një hap drejt diturisë.

-Përpjekja për të sjellë parajsën në tokë, udhëheq, pa përjashtim, në ferr.

-Mund të kemi ardhur të gjithë me anije të ndryshme, por tani jemi të gjithë në të njëjtën barkë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

17	1	8	4	2	4		13	1		13	1
18	3	1	4		18		3		17	13	1
8	1	10		10		10	1	3	1	6	12
3		1	10	2	3	6	14	1	12	2	4
	13	3	5	4	2	8	4	1	12	4	2
15	9	6	15	1	12	4	6		6	3	3
17	2	4	5	12		2	14		17	5	1
	8	1	7	6		3	1	10	1		2
15	5	12			4	6	4	18	7	7	1
1	3	2	8		1	5			2	12	2
20	19		1	3		20	5	4	6	10	2
6	1		10	2	3	2	12	15	18	2	5

S	T	A	R	E	T	I	K	E	T	A	T
A	R	M	I	K	S	T	O	L	I	T	E
L	I	O	R	O	M	I	N	A	T		
L	O	C	A	B	A	R	E	T	L	A	
A	B	A	T	E	R	I	T	E	A	R	
T	R	I	M	E	R	I	T	E	A	N	E
A	R	T	U	R	O	U	I	M	A	T	T
A	R	S	E	N	E	A	R	A			
A	D	A	T	M	E	T	R	I	C		
P	A	K	T	P	I	R	A	T	E	R	I
K	U	A	L	I	T	E	T	I	E	P	
L	E	C	E	P	I	N	A	T	A		

Thënie të mënçura

- -Sigurisht që të gjithë jemi të barabartë para ligjit. Ndalohet e njëta gjë, edhe të pasurit dhe të varfrit të flejnë poshtë urave, për të lypur dhe për të vjedhur bukë.
- -Qesh dhe bota do të qeshë me ty. Qaj dhe do të qash i vetëm
- -Duhet të mësojmë të ecim, para se të mundemi të vrapojmë.
- -Kur ligji dhe morali përplasen me njëri-tjetrin, qytetari ka zgjedhjen të humbi perceptimin e moralit apo të humbi respektin e tij për ligjet.

